FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Ekstra	Maj	2000

Akte të papublikuara

Dhjetor 1998 - Janar 1999

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i KM nr.805, datë 24.12.1998	Për kthimin e vlerave financiare nga shoqëria në administrim "Fabiona", sh.p.k., të përndjekurve politikë	33
Vendim i KM nr.806, datë 24.12.1998	Për kthimin e vlerave financiare kreditorëve që kanë depozituar kapitalet apo letrat me vlerë në shoqërinë në administrim "Flora & Co" sh.p.k.....	34
Vendim i KM nr.807, datë 24.12.1998	Për shpërblimin e anëtarëve të komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik.....	34

Vendim i KM nr. 808, datë 24.12.1998	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 26.9.1997, nr. 335, datë 2.9.1997 dhe nr. 382, datë 20.5.1996.....	35
Vendim i KM nr. 817, datë 28.12.1998	Për përdorim fondesh buxhetore për blerje banesash...	36
Vendim i KM nr. 823, datë 30.12.1998	Për dhënie ndihme financiare disa familjeve të dëmtuara.....	37
Vendim i KM nr. 825, datë 30.12.1998	Për disa masa për riaktivizimin dhe likuidimin e disa ndërmarrjeve të përbashkëta, në sistemin e bujqësisë dhe ushqimit.....	39
Vendim i KM nr. 826, datë 30.12.1998	Për rritjen e pensioneve.....	40
Vendim i KM nr. 828, datë 30.12.1998	Për shitjen e mjeteve dhe të teknikës luftarake të ushtrisë, të dala jashtë përdorimit, në formën e skrapeve.....	42
Vendim i KM nr. 830, datë 28.12.1998	Për kriteret e llogaritjes së vlerës vjetore të qirasë së tokave bujqësore, pyjore, me bimë pyjore, livadheve dhe kullotave, pasuri shtetërore.....	44
Vendim i KM nr. 831, datë 28.12.1998	Për mënyrën e dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore.....	45
Vendim i KM nr. 833, datë 28.12.1998	Për miratimin e strategjisë së qeverisë për zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri.....	46
Vendim i KM nr. 834, datë 30.12.1998	Për procedurat e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a.....	62
Vendim i KM nr.6, datë 7.1.1999	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.598, datë 30.12.1997 "Për administrimin dhe shitjen e mallrave të konfiskuara në bazë të ligjit nr.8262, datë 15.12.1997 "Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit dhe pijeve alkoolike dhe për ngjyrosjen e nënprodukteve të naftës".....	71
Vendim i KM nr.10, datë 14.1.1999	Për dokumentacionin e përfitimit të ndihmës ekonomike....	71
Vendim i KM nr.12, datë 7.1.1999	Për objektet që do të mbeten në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.....	72
Vendim i KM	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave	

nr. 14. datë 7.1.1999	nr.152, datë 5.4.1994 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve".....	75
Vendim i KM nr. 20, datë 21.1.1999	Për miratimin, në parim, të projektit "Për rehabilitimin e grupit sektorial të ujësjellësit të Tiranës dhe asistencën teknike të menaxhimit të ndërmarrjes së ujësjellësit".....	76
Vendim i KM nr. 22, datë 21.1.1999	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.43, datë 17.1.1998 "Për organizimin e panaireve dhe të ekspozitave tregtare".....	76
Vendim i KM nr.23, datë 21.1.1999	Për shpërblimin e punonjësve të shoqërive tregtare, që privatizohen.....	77
Vendim i KM nr.24, datë 21.1.1999	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.446, datë 9.7.1998, "Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë" ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.684, datë 28.10.1998.....	78
Vendim i KM nr.26, datë 14.1.1999	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore".....	78
Vendim i KM nr.27, datë 21.1.1999	Për një ndryshim në vendimin nr.423, datë 9.7.1998 "Për pjesëmarrjen, me kontratë administrimi, të sektorit privat, në ndërmarrjet e ujësjellësve, të bashkisë së Tiranës dhe të rretheve Tiranë dhe Durrës" dhe për përfshirjen e ndërmarrjes së ujësjellësit të bashkisë së Tiranës dhe të rrethit të Tiranës në kontratën për asistencë teknike.....	79
Vendim i KM nr.28, datë 21.1.1999	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.730, datë 19.11.1998 "Për miratimin e rritjes së kuotës së anëtarësimit në fondin monetar ndërkombëtar".....	79
Vendim i KM nr.29, datë 21.1.1999	Për privatizimin e shoqërive tregtare sh.a. "albkromi" dhe sh.a. "AMC" që veprojnë në sektorë me rëndësi të veçantë strategjikë".....	80
Vendim i KM nr.32, datë 25.1.1999	Për dhënien në enfiteozë të ndërmarrjes së prodhimit të çelikut, Elbasan.....	81

Vendim i KM nr.34, datë 7.1.1999	Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimin e personaliteteve të larta.....	81
Vendim i KM nr.35, datë 21.1.1999	Për riorganizimin e drejtorive të policisë në prefektura.....	86
Vendim i KM nr.36, datë 21.1.1999	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.221, datë 4.4.1998, nr.319, datë 23.5.1998, nr.250, datë 30.4.1998 dhe nr.178, datë 6.3.1998.....	87
Vendim i KM nr.38, datë 25.1.1999	Për miratimin e dhënies në koncesion të sh.a. "Superfosfatit" Kurbin.....	88
Vendim i KM nr.39, datë 21.1.1999	Për rishikimin e funksioneve, të strukturës dhe organikës së kryeministrisë dhe të disa ministrive.....	89
Vendim i KM nr.43, datë 21.1.1999	Për mbulimin e vlerës së mallrave të shoqërive huamarrëse të vjedhura e të grabitura në depot e drejtorisë së rezervave shtetërore.....	89
Vendim i KM nr.48, datë 28.1.1999	Për krijimin e bordit të hetimit të aksidenteve dhe të incidenteve ajrore të aviacionit civil.....	90
Vendim i KM nr.50, datë 28.1.1999	Për përcaktimin e pagës mbi të cilën do të llogaritet taksa e solidaritetit.....	92

V E N D I M

Nr. 805, datë 24.12.1998

PËR KTHIMIN E VLERAVE FINANCIARE NGA SHOQËRIA NË ADMINISTRIM "FABIONA", SH.P.K., TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 11, të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozim të zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëria në administrim "Fabiona", sh.p.k., deri në fund të muajit qershor 1999, t'u kthejë të përndjekurve politikë, kreditorë të saj, depozitat e grumbulluara.

2. Të ardhurat neto, që do të sigurohen nga shitja e prodhimeve të shoqërisë në administrim "Fabiona" sh.p.k., deri në qershor të vitit 1999, pasi të shlyhen detyrimet ndaj shtetit, nëpërmjet administratorit, të depozitohen në llogarinë për shlyerje të kreditorëve, të çelur posaçërisht pranë Bankës së Kursimeve dhe të përdoren vetëm për pagesën e të përndjekurve politikë, kreditorë të kësaj shoqërie.

3. Administratori i shoqërisë, për shlyerjen e të përndjekurve politikë, kreditorë të kësaj shoqërie, të bashkërendojë punën me Institutin e Integrimit të të Përndjekurve Politikë dhe me shoqërinë në administrim "Fabiona", sh.p.k.

4. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe me përfundimin e shlyerjes së kreditorëve, administrimi i shoqërisë në administrim "Fabiona", sh.p.k., konsiderohet i përfunduar. Në këtë rast, ndërmjet shoqërisë në administrimin "Fabiona", sh.p.k., dhe administratorit hartohet dokumentacioni përkatës i përfundimit të administrimit, të cilit i bashkëlidhet akti i kontrollit.

5. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit, me fillimin e likuidimit të kreditorëve, të zgjidhin përfundimisht pronësinë mbi këtë objekt, në përputhje me kriteret e rregullat e caktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 192 dhe 195, datë 20.3.1998, për shitjen me rezervë apo për riprivatizimin e saj.

6. Ministria e Financave dhe institucionet financiare në varësi të saj të saktësojnë, deri në përfundim të procesit të administrimit, realizimin e detyrimeve të kësaj shoqërie ndaj shtetit, nëpërmjet rikontrollit të bilanceve financiare, si dhe të vlerave financiare të investuara shoqëria në administrimin "Fabiona", sh.p.k.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Ministria e Financave dhe Grupi Mbikëqyrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 806, datë 24.12.1998

PËR KTHIMIN E VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE QË KANË DEPOZITUAR KAPITALET APO LETRAT ME VLERË NË SHOQËRINË NË ADMINISTRIM "FLORA & CO" SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë"", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëria në administrim "Flora & Co", sh.p.k., deri më 31 janar të vitit 1999, të përfundojë kthimin e vlerave financiare kreditorëve, që kanë depozituar pranë saj kapitalet apo letrat me vlerë.

2. Kreditorët, që kanë depozituar kapitalet apo letrat me vlerë pranë shoqërisë në administrim "Flora & Co", sh.p.k., të paraqiten pranë administratorit të kësaj shoqërie, për njohjen e pretendimeve të tyre brenda datës 15 janar 1999.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe me përfundimin e shlyerjes së kreditorëve, administrimi i shoqërisë "Flora & Co" sh.p.k. konsiderohet i përfunduar. Në këtë rast, ndërmjet shoqërisë në administrim "Flora & Co", sh.p.k. dhe të administratorit hartohet dokumentacioni përkatës i përfundimit të administrimit, të cilit i bashkëlidhet akti i kontrollit.

4. Ngarkohet Grupi Mbikëqyrës pranë Këshillit të Ministrave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 807, datë 24.12.1998

PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË DEKLARIMIT TË PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr. 7903, datë 8.3.1995 "Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik", me propozimin e

Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Anëtarët e komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik, të shpërblehen për punën e kryer në masën 10 000 lekë në muaj.

2. Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në buxhetin e miratuar për vitin 1998 i shtohet një fond prej 108 mijë lekësh, për shpërblimin e anëtarëve të komisionit.

3. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.3.1998

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 808, datë 24.12.1998

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 396, DATË 26.9.1997, NR. 335, DATË 2.9.1997 DHE NR. 382, DATË 20.5.1996

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 2, të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 26.9.1997 "Për detyrat e grupit të mbikëqyrjes të kontrollit financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", bëhen këto ndryshime:

Në pikën 5, shtohet ky paragraf, me këtë përmbajtje:

"Fondi i pagave dhe i shpenzimeve administrative, që kryhen për llogari të Grupit Mbikëqyrës, të parashikohen si zë i veçantë në buxhet brenda buxhetit të Kryeministrisë.

Pas pikës 5, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

"Përpunimi i dokumentacionit financiar të shoqërive huamarrëse dhe përgatitja e regjistrave për rishpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve, kryhet pranë Qendrës së Informatizimit Financiar.

Shpenzimet e përpunimit të deklaratave të kreditorëve përballohen me të ardhurat që sigurohen nga shitja e tyre kreditorëve.

Për llogaritjen e borxhit të shoqërive huamarrëse shpenzimet mbulohen nga buxheti i shtetit dhe caktohen si zë i veçantë në shpenzimet e Grupit Mbikëqyrës".

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 2.9.1997 “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, në pikën 3 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kryetari i Grupit Mbikëqyrës për kontrollin e shoqërive huamarrëse”.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 20.5.1996 “Për zbatimin e ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore, suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit””, në listën për grupin e dytë germa “A”, në pikën 9, të nenit 1 të këtij ligji, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje: “Kryetari i Grupit Mbikëqyrës për kontrollin e shoqërive huamarrëse”.

4. Anëtarët e Grupit Mbikëqyrës barazohen në trajtim me zëvendësministrat dhe gëzojnë të gjitha të drejtat e përfituara nga ana e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 817, datë 28.12.1998

PËR PËRDORIM FONDESH BUXHETORE PËR BLERJE BANESASH

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nga fondet e buxhetit të shtetit të vitit 1998 miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit për zërin “investime në banesa”, të përdoren 44.52 milionë lekë për blerje banesash në tregun e lirë për familjet e pastreha në masën dhe kategoritë e mëposhtme:

a) 17.12 milionë lekë për qytetarët me statusin e pastrehë dhe të përndjekurit politikë;

b) 17.12 milionë lekë për familjet me aktmarrëveshje të pazbatuara me organet e pushtetit lokal;

c) 10.28 milionë lekë për qytetarët e pastrehë me statusin e të pastrehë dhe të verbrit e grupit të parë.

2. Përdorimi i fondeve të mësipërme të bëhet nëpërmjet blerjeve nga tregu i lirë i banesave nga ana e vetë qytetarëve, që përfitojnë sipas shkronjave “a”, “b”, dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, mbështetur në listat nominale dhe strukturat e apartamenteve tip që përfitojnë, të hartuara nga Instituti i të Përndjekurve Politikë, Shoqata e të Verbërve, bashkia e Tiranës dhe të miratuara nga organet e pushtetit lokal.

3. Enti Kombëtar i Banesave, bazuar në listat nominale nga institucionet e

përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi kryen veprimet financiare me pronarët-shitës të banesave, vetëm pas paraqitjes dhe verifikimit të dokumentacionit ligjor përkatës, që vërtetojnë kryerjen e aktit të blerjes së banesave nga qytetarët, që e përfitojnë atë sipas këtij vendimi.

4. Enti Kombëtar i Banesave, sipas listave të shoqëruara me strukturat përkatëse, vë në dispozicion të secilit qytetar masat limit të përfitimit falas:

a) Për apartamente (1+1) shumën prej 1.14 milionë lekë;

b) Për apartamente (2+1) shumën prej 1.43 milionë lekë;

c) Për apartamente (3+1) shumën prej 1.66 milionë lekë.

Këto shuma limit, të cilat do të indeksohen me vlerën e koeficientit "k", sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 5.1.1998 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit "k"", të përballohen nga buxheti i shtetit.

5. Kur shuma e vënë në dispozicion të qytetarëve, sipas pikës 4 të këtij vendimi, e indeksuar dhe me koeficientin "k" rezulton më e madhe se vlera e tregut, atëhere qytetari nuk do të përfitojë më shumë se vlera e tregut.

6. Fondi prej 44.52 milionë lekësh të kalojë në llogari të veçantë në Bankën e Kursimeve për t'u përdorur nga Enti Kombëtar i Banesave, për familjet e pastreha që përfitojnë sipas këtij vendimi.

7. Qytetarëve që përfitojnë sipas këtij vendimi, kur nuk kryejnë veprimet për blerjen e banesave brenda një afati prej 4-muajve nga momenti i vënies në dispozicion të fondeve përkatëse, u humbet e drejta e përfitimit si familje të pastreha.

8. Ngarkohen Ministria e Financave, Enti Kombëtar i Banesave, Pushteti Lokal, Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë dhe Shoqata e të Verbërve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 823, datë 30.12.1998

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE DISA FAMILJEVE TË DËMTUARA

Në mbështetje të ligjit nr. 8283, datë 3.2.1998 "Për buxhetin e shtetit të vitit 1998" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 206, datë 26.3.1998 "Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve, në raste fatkeqësish", me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Portez, në rrethin e Fierit, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i

shtohen 503 776 (pesëqindetre mijë e shtatëqindeshtatëdhjetegjashtë) lekë për dhënie ndihme z. Pajtim Muhedin Malaj. Ky fond të përdoret në masën 423 776 (katërqindenjëzetetre mijë e shtatëqindeshtatëdhjetegjashtë) lekë për blerje banese dhe 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

2. Ngarkohet komuna Portez të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Komunës Greshicë, në rrethin e Mallakastrës, në buxhetin e miratuar për vitin 1988, i shtohen 220 000 (dyqindenjëzet mijë) lekë për dhënie ndihme z. Skënder Haxhi Lamaj, banues në fshatin Greshicë. Ky fond të përdoret në masën 120 000 (njëqindenjëzet mijë) lekë për riparimin e banesës dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

4. Ngarkohet komuna Greshicë të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Ngarkohet prefektura e Fierit të kontrollojë zbatimin e pikave 1,2,3 dhe 4 të këtij vendimi.

6. Komunës Mollas, në rrethin e Kolonjës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 233 965 (dyqindetridhjetetre mijë e nëntëqindegjashtepesë) lekë për dhënie ndihme z. Etem Dalip Çaushi, banues në fshatin Qafëzez. Ky fond të përballohet në masën 173 965 (njëqindeshtatëdhjetetre mijë e nëntëqindegjashtëdhjetepesë) lekë për riparimin e ndërtesës dhe 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

7. Ngarkohet komuna e Mollasit të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Komunës Drenovë, në rrethin e Korçës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 358 618 (treqindepesëdhjetetetë mijë e gjashtëqindetetëmbëdhjetë) lekë për dhënie ndihme z. Mitro Petro Kaçi, banues në fshatin Mborje të kësaj komune. Ky fond të përdoret në masën 258 618 (dyqindepesëdhjetetetë mijë e gjashtëqindetetëmbëdhjetë) lekë për riparimin e ndërtesës dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

9. Ngarkohet komuna Drenovë të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi.

10. Ngarkohet prefektura e Korçës të kontrollojë zbatimin e pikave 6,7, 8 dhe 9 të këtij vendimi.

11. Bashkisë së Peqinit, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 316 763 (treqindegjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqindegjashtëdhjetetre) lekë për dhënie ndihme z. Myslim Hajrulla Kasa. Ky fond të përdoret në masën 276 763 (dyqindeshtatëdhjetegjashtë mijë e shtatëqindegjashtëdhjetetre) lekë për riparimin e ndërtesës dhe 40 000 (dyzet mijë) lekë për blerje pajisjesh e orendish.

12. Ngarkohet bashkia e Peqinit të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 11 të këtij vendimi.

13. Komunës Gjergjan, në rrethin e Elbasanit, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 407 760 (katërqindeshtatë mijë e shtatëqindegjashtëdhjetë) lekë për dhënie ndihme z. Hyqmet Myslim Çekrezi, banues në fshatin Gjergjan të kësaj komune. Ky fond të përdoret në masën 327 760 (treqindenjëzeteshtatë mijë e shtatëqindegjashtëdhjetë) lekë për blerje banese dhe 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

14. Ngarkohet komuna Gjergjan të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 13 të këtij vendimi.

15. Ngarkohet prefektura e Elbasanit të kontrollojë procedurat e zbatimit të pikave

11,12,13 dhe 14 të këtij vendimi.

16. Komunës Bujan, në rrethin e Tropojës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 364 330 (treqindegjashtëdhjetekatër mijë e treqindetridhjetë) lekë për dhënie ndihme z. Rasim Xhem Ahmetaj, banues në fshatin Gri të kësaj komune. Ky fond të përdoret në masën 264 330 (dyqindegjashtëdhjetekatër mijë e treqindetridhjetë) lekë për blerje banese dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

17. Ngarkohet komuna e Bujanit të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 16 të këtij vendimi.

18. Ngarkohet prefektura e Kukësit të kontrollojë zbatimin e procedurave të pikave 16 dhe 17 të këtij vendimi.

19. Komunës Hajmel në rrethin e Shkodrës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohen 527 500 (pesëqindenjëzeteshtatë mijë e pesëqind) lekë për dhënie ndihme z. Pjetër Gjergj Prendi, banues në fshatin Nenshat të kësaj komune. Ky fond të përdoret në masën 427 500 (katërqindenjëzeteshtatë mijë e pesëqind) lekë për blerje banese dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për blerje pajisjesh dhe orendish.

20. Ngarkohet komuna Hajmel të kontrollojë përdorimin e këtij fondi për destinacionet e përcaktuara në pikën 19 të këtij vendimi.

21. Ngarkohet prefektura e Shkodrës të kontrollojë procedurat e zbatimit të pikave 19 dhe 20 të këtij vendimi.

21.Fondi prej 2.932.712 (dy milionë e nëntëqindetridhjetedy mijë shtatëqindedymbëdhjetë) lekë të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 825, datë 30.12.1998

PËR DISA MASA PËR RIAKTIVIZIMIN DHE LIKUIDIMIN E DISA NDËRMARRJEVE TË PËRBASHKËTA, NË SISTEMIN E BUJQËSISË DHE USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8283, datë 3.2.1998 "Për buxhetin e shtetit për vitin 1998", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Për riaktivizimin e ndërmarrjes së përbashkët "Agri-Gose" sh.p.k. Kavajë:

a) T'i jepen kësaj shoqërie në përdorim 78.98 ha tokë bujqësore, disponibël, shtetërore në zonën e Bashtovës, në veri të lumit Shkumbin, me numër kadastral a.35=45,45 ha; a.36=3,11 ha; a.38=30,42 ha; në këmbim të sipërfaqes prej 50 ha tokë bujqësore në Gose, në vijim të kushteve kontraktore përkatëse.

b) Shoqëria "Agri-Gose", sh.p.k., Kavajë, të paguajë, në favor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, kontributin e papaguar për periudhën 1993-1998, pa kamatëvonesat përkatëse. Kamatëvonesat prej 12 milionë lekësh, të përballohen nga buxheti i shtetit.

2. Për riaktivizimin e ndërmarrjes së përbashkët "Pranvera" sh.p.k., Sukth, Durrës:

a. T'i jepet kësaj shoqërie në përdorim edhe 6 ha tokë bujqësore të tjera në zonën e ish NB-së, Spitallë, pjesë e parcelës me numër kadastral 76.

b. Pjesës së kapitalit të ortakut shtetëror shqiptar, t'i shtohet, si kontribut në natyrë, një magazinë e degës së farnave, Shijak.

c. Ministria e Pushtetit Lokal të marrë masa për sistemimin me zyra të bashkisë së Sukthit.

3. Për riaktivizimin e ndërmarrjes së përbashkët "Al-Gr-Vurg" sh.p.k., Sarandë, pjesës së kapitalit të ortakut shtetëror, shqiptar t'i shtohen, si kontribut në natyrë, tri objekte nga Ndërmarrja e Ujërave, Tiranë.

4. Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit i shtohen 20 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Ky fond të përdoret për të paguar pagat, kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shpenzime të tjera për punonjësit e domosdoshëm në ndërmarrjet e përbashkëta, të cilat kanë ndërprerë veprimtarinë që para disa viteve dhe po negociohet ose janë futur në procesin e likuidimit dhe të privatizimit. Efektet financiare i shtrin që nga data 1.7.1997.

Të ardhurat nga likuidimi dhe privatizimi i këtyre ndërmarrjeve, t'i kalojnë Buxhetit të Shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal dhe këshillat e rretheve Durrës, Kavajë e Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 826, datë 30.12.1998

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës e Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96 të ligjit 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të paragrafit të dytë,

të nenit 12 të ligjit nr. 8392, datë 2.9.1998 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.5.1995 dhe me ligjin nr. 8286, datë 16.2.1998, ndryshohen si vijon:

“Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi rriten në masën 10 për qind.

Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare rriten në masën 15 për qind.”

2. Rritjen në masën e mësipërme e përfitojnë dhe pensionet që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.3.1999, duke përfshirë edhe këtë datë.

Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim nuk mund të caktohen më pak se 4400 lekë në muaj. Pensioni maksimal mbetet 8000 lekë në muaj.

3. Shtesa mujore e përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 21.6.1993 “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, rritet në masën 10 për qind.

4. Pensionet e pleqërisë të caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, pensionet e caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të dytë të nenit 12 të ligjit nr. 8392, datë 2.9.1998 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 ndryshuar me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995 dhe me ligjin nr. 8286, datë 16.2.1998, rriten në masën 10 për qind.

Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96, të ligjit 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, rriten në masën 15 për qind.

Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar që caktohen sipas paragrafit të parafundit të nenit 96, të ligjit 7703, datë 11.5.1993, si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të dytë, të nenit 12 të ligjit nr. 8392, datë 2.9.1998 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.5.1995 dhe me ligjin nr. 8286, datë 16.2.1998 me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 1155 lekë në muaj.

5. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr. 758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut” rriten në masën 10 për qind.

6. Efektet financiare nga rritja e pensioneve llogariten në shumën 154.8 milionë lekë në muaj dhe të përballohen nga fondi i Sigurimeve Shoqërore të programuara në buxhetin e vitit 1999.

7. Për përballimin e volumit të punës për rritjen e pensioneve dhe për prodhimin e urdhër pagesave të reja, Instituti i Sigurimeve Shoqërore të përdorë 4.5 milionë lekë, të cilat të përballohen brenda buxhetit të shpenzimeve administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 1999.

8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse në bazë dhe për zbatimin e tij. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 828, datë 30.12.1998

PËR SHITJEN E MJETEVE DHE TË TEKNIKËS LUFTARAKE TË USHTRISË, TË DALA JASHTË PËRDORIMIT, NË FORMËN E SKRAPEVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Mbrojtjes autorizohet, që brenda vitit 1999, të organizojë shitjen nëpërmjet ankandit të 15 000 tonë skrapeve që ka në administrim, nga nxjerrja jashtëpërdorimit të anijeve dhe mjeteve lundruese të Forcave të Mbrojtjes Detare, sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që fitojnë ankandin mund të tregtojnë sasinë e skrapeve të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, brenda vendit ose ta eksportojnë atë.

3. Të ardhurat që përfitohen nga shitja e skrapeve, të administrohen nga Ministria e Mbrojtjes, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 9.7.1998 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lidhja A

LISTA
E MJETEVE LUNDRUESE (ANIJEVE) TË FORCAVE TË MBROJTJES DETARE QË HIQEN NGA FORMACIONI I LUFTIMIT
(Nga Organika Luftarake e Mjeteve)

Nr.	Emërtimi i anijes	Numri i bordit	Emërtimi taktik i anijes	Viti i prodh.	Viti i vënies shfryt.	Amort në përqind	Shënime
1.	Nëndetëse	331	Stuhija	1955	1956	123	
2.	"	332	Tufani	1955	1956	123	
3.	"	333	Rrufeja	1955	1956	123	
4.	"	334	Vetëtima	1955	1956	123	
5.	Gjuajtës Detar i Madh	323	Buna	1952	1955	126	Mbytur në Gjiun e Vlorës
6.	Mina Heqëse e Vogël	223	Vlora	1952	1955	126	Mbytur tek skaljera B.P
7.	"	224	Saranda	1952	1955	126	Mbytur tek skaljera B.P.
8.	"	226	Lezha	1954	1955	126	
9.	"	228	Himara	1952	1955	126	

10.	Katër Silurues	103	Shqiponja	1986	1968	87	
11.	“	202	Partizani	1954	1954	129	
12.	“	204	Sulmuesi	1954	1955	126	
13.	“	205	Shqiponja	1954	1955	126	
14.	“	206	Besniku	1954	1955	126	
15.	“	302	Patrioti	1968	1968	87	Mbytur në V. Bazimin S.
16.	“	303	Delfini	1968	1968	87	Mbytur në V. Bazimin S.
17.	“	306	Çeliku	1967	1968	87	
18.	“	307	Luftëtari	1953	1954	129	Mbytur në V. Bazimin S.
19.	“	308	Lavdia	1953	1954	129	Dëmtuar 40% e skafit (vjedh)
20.	“	309	Heroi	1953	1954	129	Mbytur në V. Bazimin S.
21.	“	310	Trimi	1953	1954	129	Mbytur në V. Bazimin S.
22.	“	311	Fitimtari	1953	1954	129	Mbytur në V. Bazimin
23.	“	312	Shigjeta	1953	1954	129	
24.	“	401	Furtuna	1953	1968	87	
25.	“	402	Bubullima	1968	1968	87	Mbytur në V. Bazimin Lir
26.	“	405	Rrebeshi	1968	1968	87	Mbytur në V. Bazimin Lir
27.	Maune nafte 500 tonë	251	Cërriku	1957	1957	120	
28.	Anije polumbare	342	Finiqi	1976	1976	63	Mbytur pranë Brindizit
29.	Rimorkiator	523	Mulqinak	1957	1958	117	Mbytur në V. Bazimin S.
30.	Rimorkiator	=	S. Frashëri	1957	1958	117	Mbytur në V. Bazimin S.
31.	Stac. karik. lundrues	=	Oriku	1959	1959	114	
32.	Anije transporti	=	22 Tetori	1978	1978	57	Mbytur në Gjiun e Vlorës
33.	Anije transporti	=	Shkumbini	1958	1958	117	Mbytur Në Gjiun e Vlorës
34.	Çisterni nafte	424	Patosi	1954	1956	123	Mbytur në V. Bazimin S.
35.	Slur kapëse	345	Joni	1957	1958	117	Mbytur Në Gjiun e Vlorës
36.	Katër RADE	451	=	1957	1958	117	Mbytur Në kanalin e Otrantos
37.	Motoskaf M 20	=	=	1957	1958	117	Mbytur Vend Baz Pash.
38.	Pilotazhi	=	=	1980	1980	51	

V E N D I M

Nr. 830, datë 28.12.1998

PËR KRITERET E LLOGARITJES SË VLERËS VJETORE TË QIRASË SË TOKAVE BUJQËSORE, PYJORE, ME BIMË PYJORE, LIVADHEVE DHE KULLOTAVE, PASURI SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave, pasuri shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kriteret për llogaritjen e vlerës vjetore të qirasë së tokave të jenë:

a) të ardhurat aktuale mesatare, të realizuara nga kulturat bujqësore të tre viteve të fundit, për të njëjtin nivel pjellorie të saj. Vlera e qirasë të jetë 30 për qind e të ardhurave neto;

b) largësia e tokës bujqësore nga qendra urbane, si më poshtë:

Për çdo 1 km pas distancës prej 10 km vlera e qirasë së tokës bujqësore do të zbritet në 1 për qind.

2. Në çdo rast, vlera fillestare e ankandit të qirasë së tokës bujqësore, pasuri shtetërore, e bazuar në pjellorinë e tokës, sipas vlerësimit të bërë nga Instituti i Studimit të Tokave, nuk duhet të jetë më e ulët se:

Kategoria e tokës	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII-IX
Vlera e qirasë lekë/ha	30 000	26 000	22 000	18 000	14 500	11 500	7 000	6 000

Këto vlera janë për vitin 1998. Për vitet pasardhëse bëhet indeksimi i tyre, në përputhje me të dhënat e fillimit të vitit të treguesve makroekonomikë, të publikuar nga organi shtetëror i autorizuar (INSTAT).

3. Vlera fillestare e ankandit të tokave pyjore dhe me bimësi pyjore është e barasvlershme me kategorinë VIII-X të tokave bujqësore.

4. Kriteret e llogaritjes së vlerës vjetore të qirasë së livadheve dhe të kullotave të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 6.6.1994 "Për tarifat e kullotjes në fondin kullosor të kullotave e pyjeve në administrimin e drejtorive të shërbimit pyjor të kullotave dhe të komunave".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 831, datë 28.12.1998

PËR MËNYRËN E DHËNIES ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE, PASURI SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, livadheve dhe kullotave, që janë pasuri shtetërore" dhe të ligjit nr. 8406, datë 17.9.1998 "Për një ndryshim në ligjin nr. 8318, datë 1.4.1998 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, livadheve dhe kullotave, që janë pasuri shtetërore"", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Përcaktimi, vlerësimi dhe përparësia e sipërfaqes së tokës bujqësore, pasuri shtetërore, që jepet me qira dhe miratimi i studimeve.

1. Drejtoria e bujqësisë dhe ushqimit në rreth bën studimin për tokat bujqësore, të regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurisë të paluajtshme si pasuri shtetërore dhe që jepen me qira, në rrethin ku ajo shtrin juridiksionin.

Në studim përfshihen:

a) Sipërfaqja e tokës bujqësore, pasuri shtetërore, që jepet me qira.

b) Treguesit teknikë për sipërfaqet e tokës bujqësore.

c) Treguesit për prodhimin dhe të ardhurat për njësi sipërfaqe në mesataren e zonës, që parashikohet të jepet tokë bujqësore, pasuri shtetërore, me qira.

ç) Propozimet për vlerën fillestare të ankandit.

d) Propozimet për afatin kohor të dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, për zona të caktuara.

e) Propozimet për qëllimet e qiradhënies.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit shqyrton dhe miraton studimet e paraqitura nga drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit në rrethe.

II. Ngritja dhe funksionimi i bordit të dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore.

1. Bordi i dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, përbëhet nga nëntë anëtarë, me specialistë të drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit dhe të seksioneve të urbanistikës, të kadastrës, të mjedisit dhe jurist. Anëtarë të bordit janë: Drejtori i drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit të rrethit, një agronom, një ekonomist dhe një specialist i blegtorisë së drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit në rreth, specialist i mjedisit, specialist i kadastrës, specialist i urbanistikës, jurist i këshillit të rrethit (bashkisë), specialisti i komunës, në të cilën ndodhet toka, që do të jepet me qira.

2. Kryetari i bordit të dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, të jetë drejtori i drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit në rreth. Krijimi i bordit bëhet me urdhër të

ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, sipas kritereve të përcaktuara në ligj.

3. Kryetari i bordit të dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, emërohet dhe shkarkohet nga ky funksion nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

4. Bordi për dhënien me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, zbaton udhëzimin "Për procedurën e zhvillimit të dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore".

5. Bordi i dhënies me qira të tokës bujqësore, pasuri shtetërore, përcakton fituesin dhe ia paraqet për miratim ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit. Pas miratimit nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, bordi shpall fituesin dhe drejtoria e bujqësisë dhe ushqimit e rrethit lidh kontratën përkatëse.

6. Vlera e qirasë e përcaktuar në kontratë, për çdo vit indeksohet në përputhje me të dhënat e fillimit të vitit, të treguesve makroekonomikë, të publikuar nga organi shtetëtor i autorizuar (INSTAT).

III. Mënyra e pagesës së vlerës së qirasë

1. Të ardhurat financiare, që sigurohen nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pasuri shtetërore, arkëtohen për llogari të buxhetit të shtetit.

2. Vjelja e të ardhurave financiare bëhet 25 për qind të vlerës vjetore, në fund të çdo tremujori.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 833, datë 28.12.1998

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË QEVERISË PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Miratimin e strategjisë së qeverisë për zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e strategjisë, sipas planit të veprimit, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË QEVERISË PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË SHQIPËRI

Dhjetor 1998

PËRMBAJTJA

1. Reforma institucionale
Ristrukturimi i ndërmarrjeve të ujrave
Ristrukturimi i shërbimit pyjor
Shërbimi këshillimor
2. Problemet e tokës
Krijimi i një tregu funksional të tokës
bujqësore dhe pasurive të tjera të paluajtshme
Mbrojtja dhe administrimi i tokës
3. Prodhimi bimor
Drithërat
Perimet
Pemëtaria
4. Prodhimi blegtoral
5. Shërbimi veterinar
6. Industria ushqimore
Agropërpunimi
Kontrolli ushqimor
7. Marketingu
Marketingu dhe politikat tregtare
Marketingu dhe tregtia e inputeve bujqësore
8. Organizimi i fermave dhe kredia rurale
Organizimi i fermave
Kredia dhe financat rurale
9. Zhvillimi rural
10. Kërkimi shkencor
11. Shërbimi këshillimor
12. Shërbimi i mbrojtjes së bimëve
13. Informacioni statistikor
14. Politikat pyjore dhe mjedisore
15. Peshkimi

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
REFORMA INSTITUCIONALE RISTRUKTURIMI I NDËRMARRJEVE TË UJRAVE	- Ristrukturimi i ndërmarrjeve të ujërave rritja e kapacitetit të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore	- Kryerja e studimit për ristrukturimin e ndërmarrjeve të ujrave me faza - Bashkimi i ndërmarrjeve të ujrave brenda të njëjtit rreth - Bashkimi i ndërmarrjeve të ujërave të rretheve fqinje me burime ujore të përbashkëta - Fillimi i organizimit të ndërmarrjeve të ujërave mbi bazën e baseneve ujëmbledhëse sipas vendimeve të Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU) - Mbështetje për krijimin e shoqatave të përdorimit të ujit (SH.P.U) dhe transferimi i veprave ujitëse pas përfundimit të rehabilitimit - Mbështetje për krijimin e federateve të përdorimit të ujit	- Ristrukturimi i ndërmarrjeve të ujërave mbi bazën e banesave ujëmbledhëse në të gjithë vendin - Administrimi i fondeve publike me kritere ekonomike - Konsolidimi i veprimtarisë së shoqatave të përdorimit të ujit për administrimin veprave ujitëse dhe për rritjen e aktiviteteve të tjera jashtë ujitjes - Zgjerimi i federatave të përdorimit të ujit përdorimit të ujit mbi bazë rrethi ose banesash ujëmbledhëse - Ndarja e funksioneve të menaxhimit, ruajtjes dhe të drejtimit teknik në sistemin e shërbimit pyjor
RISTRUKTURIMI I SHËRBIMIT PYJOR	- Rritja e përgjegjësisë për administrimin e ujitjes nga shoqatat e federatat e përdorimit të ujit për ujitje - Riorganizimi i shërbimit pyjor drejt decentralizimit të tij	- Riorganizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve e Kullotave Krijimi i menaxhimeve rajonale - Riorganizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve e Kullotave - Krijimi i menaxhimeve rajonale	

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
REFORMA INSTITUCIONALE Shërbimi Këshillimor	- Fuqizimi dhe shtrirja e këtij shërbimi në të gjithë vendin, i lidhur ngushtë me sektorin privat dhe me tendencë drejt privatizimit	- Përfshirja e 10 rretheve të reja në strukturën e Shërbimit Këshillimor Kombëtar - Riorganizimi i strukturës së Shërbimit Këshillimor në: MBU dhe deri në nivel Komune - Rritja e kapacitetit të trajnimit në të gjitha nivelet e Shërbimit Këshillimor - Fuqizimi i lidhjeve midis kërkimit dhe shërbimit Këshillimor - Ngritja e një sistemi efektiv monitorimi për Shërbimin Këshillimor	- Krijimi i 5 Qendrave të Shërbimit Këshillimor në rajonet më të rëndësishme bujqësore të vendit me theks rritjen e pavarësisë së tyre - Fuqizimi i shërbimit Këshillimor Publik nëpërmjet masmedias - Ngritja e një qendre trajnimi gjysëm private për Shërbimin Këshillimor - Fuqizimi i lidhjeve fermer-ekstension-kërkim

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
PROBLEMET E TOKËS	- Krijimi i një tregu funksional të tokës bujqësore dhe pasurive të tjera të palujtshme - Mbrojtja dhe administrimi i tokës	- Përmirësimet ligjore për: - Heqjen e kufizimeve për shitblerjen e tokës - Qiradhënien e tokës - Rregullimin ligjor për tokat e pandara - Procedurat e shitblerjes edhe pa përfunduar regjistrimi i plotë - Miratimi i planit të veprimit për regjistrimin e tokës dhe shtrirja e këtij procesi në të gjithë vendin - Hapja e zyrave të regjistrimit në të gjitha rrethet e vendit - Ngritja e zonës pilot për identifikimin e faktorëve të ndryshëm ndërveprues	Përmirësime në kuadrin ligjor për tregun funksional të tokës bujqësore - Përfundimi i regjistrimit të plotë të tokës dhe pasurive të paluajtshme në të gjithë vendin - Kryerja e survejimit fushor, përmirësimi dhe përpilimi i hartave dhe librit të parcelave për 1300 zona kadastrale - Përgatitja e akteve ligjore normative për mbështetjen e institucionalizimit të administrimit të tokës në nivel kombëtar

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
PRODHIMI BIMOR DRITHËRAT PERIMET PEMËTARIA	- Shtimi sasior dhe cilësor i prodhimit - Përmirësimi i cilësisë dhe zgjerimi i tregut të farërave dhe fidanave - Shtimi i përdorimit të plehrave kimike dhe shfrytëzimi racional i tyre - Zbatimi i teknologjive të reja dhe mekanizmi - Shtimi i sipërfaqes së ujitshme dhe kullimit - Prodhimi gjithëvjetor me synim rritjen e eksporteve - Prërtëritja dhe shtimi i sipërfaqes dhe prodhimit në pemë, ullinj e vreshta	- Ristrukturimi i shërbimit shtetëror të farërave dhe fuqizimi i prodhimit të farërave nga sektori privat. - Aderimi në ISTA dhe UPOV - Forcimi i tregut privat të inputeve bujqësore - Organizimi i shërbimit të kontrollit të plehrave - Organizimi i trajnimit të specialistëve dhe fermerëve - Shtimi i vëllimit të punimeve të mekanizuara, demonstrimi i teknologjive të reja - Zgjerimi i rehabilitimit të kullimit dhe ujitjes me përparësi zonat fushore 37000 ha ujitje (1998) 20000 ha kullim (1998) - Përkrahja për ngritjen e serrave familjare kryesisht plastike - Krijimi i 4-5 qendrave private të prodhimit të fidanëve	- Krijimi i një rrjeti të qëndrueshëm për prodhimin dhe marketingun e farës dhe fidanave - Organizimi i sistemit të monitorimit dhe testimi laboratorik i tokave - Dhënia e huave të buta për fermerët - Rritja e investimeve dhe kreditit për mekanizimin e bujqësisë - Rehabilitimi i kullimit dhe ujitjes në nivelin e parareformës - Përkrahja për ngritjen e serrave komerciale - Krijimi i qendrave rajonale të prodhimit të fidanave

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
PRODHIMI BLEGTORAL	- Vendosja e sistemeve të qëndrueshme të prodhimit blegtoral - Përmirësimi i strukturës së prodhimit blegtoral dhe balancimi i raportit ndërmjet numrit të krerëve dhe prodhimit të ushqimeve për blegtorinë - Organizimi i shërbimit zooteknik dhe veterinar, mbi bazën e qendrave rajonale dhe rrjetit laboratorik të kontrollit	- Mbështetje me legjislacionin e decentralizimit të strukturave të punës racore - Krijimi i tufëzave racore private - Mbështetja me legjislacion për ushqimet e blektorisë - Forcimi i laboratorit të kontrollit të ushqimeve për blegtorinë pranë IKZ-së - Përfundimi i 6 qendrave rajonale (Tiranë, Elbasan, Lushnjë, Fier, Korçë dhe Shkodër) për inseminimin artificial - Shtrirja e inseminimit artificial në mbi 400 pika të shpërndara në 15-20 rrethe	- Mbështetja me legjislacion e shoqatave të fermerëve për administrimin e punës racore - Mbështetja me kredi për rritjen e prodhimit të mishit dhe vezëve në zonën fushore - Mbështetja me projekte për rritjen e prodhimit nga kullotat në zonën malore - Krijimi i kuadrit ligjor për administrimin, pronësinë dhe mbrojtjen e kullotave - Vendosja e sistemit dhe të identifikimit të kafshëve, kontrollit dhe informacionit zooteknik në 6 qendra rajonale

OBJEKTET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
SHËRBIMI VETERINAR	- Kontrolli i sëmundjeve të listës A dhe B dhe të OIE-së - Kontrolli dhe monitorimi i sigurisë ushqimore - Rritja e eksportit të produkteve me origjinë shtazore si burim i madh valute	- Mbështetja me legjislacion sipas direktivave të KE - Mbështetja me projekte për kontrollin dhe çrrënjosjen e aftësi epizotike - Krijimi i sistemit të karantinës veterinare në pikat doganore - Mbështetja me legjislacion sipas direktivave të KE - Përfundimi i 2-3 laboratorëve për kontrollin e sigurisë ushqimore në rrethet kryesore të vendit - Mbështetja me projekte për kontrollin veterinar në postat e inspektimit kufitar - Mbështetja me legjislacion sipas direktivave të KE	- Mbështetja me projekte për kontrollin dhe çrrënjosjen e murtajës klasike të derrave dhe pseudopestit në shpendë - Kontrolli i sëmundjeve të tuberkulozit, brucelozës dhe plasjes në 6 qendrat rajonale - Zgjerimi i rrjetit laboratorik rajonale për kontrollin e sigurisë ushqimore në 3-4 qendra të tjera rajonale - Monitorimi i inspektimit veterinar të detit Adriatik dhe Jon për hapjen e eksporteve të molusqeve - Mbështetja me projekte për krijimin e hallkave të eksportit të mishit nga bagëtitë e imta

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
INDUSTRIA USHQIMORE	- Mbështetja me legjislacion e sektorit të ushqimit	- Hartimi i akteve ligjore dhe nën-ligjore të ligjit të ushqimit	
AGRO-PËRPUNIMI	- Zhvillimi me prioritet i agrobiznesit privat, për rritjen e standardit të jetesës dhe mirëqenies sociale në Shqipëri	- Privatizimi i plotë i ndërmarrjeve shtetërore ushqimore. - Përcaktimi i rrugëve dhe formave për nxitjen e prodhimit të duhanit, rrushit, qumështit dhe ullirit.	- Stimulimi i sektorit privat për prodhimin e produkteve ushqimore nëpërmjet politikave ekonomike
	- Hartimi i bilanceve të konsumit ushqimor vjetor (prodhim-import-konsum)	Ruajtja e konkurrencës në këta sektorë	- Mbështetja me linja kreditimi
		- Hartimi i bilancit vjetor të drithërave të bukës dhe nevojat e importit	- Bashkëpunimi për ndërtimin e një sistemi tarifor të tillë, që të stimulojë sigurimin e lëndëve të para, ndihmëse si dhe prodhimin në vend.
KONTROLLI USHQIMOR	- Organizimi i një kontrolli ushqimor shtetëror të fortë rigoroz dhe sa më efikas	- Plotësimi i ligjit “Për ushqimin” me akte nënligjore	
	- Përmirësimi i punës në kontrollin ushqimor nëpërmjet fuqizimit të rrjetit laboratorik dhe të analizimit të mallrave ushqimore	- Formulimi i një projekti për ristrukturimin dhe forcimin e administrimit të kontrollit ushqimor	- Hartimi dhe studimi i programeve shumëvjeçare të zhvillimit të industrisë ushqimore
		- Plotësimi me pajisje dhe aparatura i 12 laboratorëve të dëmtuar	- Harmonizimi i legjislacionit shqiptar me atë të KE-së si parakusht për anëtarësim.
		- Ngritja e të parit laborator rajonal të cilësisë dhe sigurisë në Durrës	
			- Ngritja e 6 laboratorëve rajonalë, në Shkodër,

			Vlorë, Elbasan, Korçë, Fier etj.

ËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
MARKETINGU DHE POLITIKAT TREGTARE	Organizimi i tregut për t'u siguruar prodhuesve një aktivitet të arsyeshëm për produktet e tyre, duke marrë parasysh kërkesat e konsumatorit dhe përpunuesve sigurinë dhe cilësinë e produktit. Krijimi i kushteve për mundësi më të mira tregu për prodhuesit në tregjet e brendshme dhe të jashtme.	Përgatitja, paraqitja, ruajtja dhe komercializmi i produkteve bujqësore, duke përmirësuar strukturat e transportit dhe komercializmit në qendrat kryesore të konsumit dhe eksportit. Forcimi i pozitave kontraktuale të prodhuesve në filierën komerciale Dhënia e përgjegjësive ligjore dhe vendimmarrjes të inspektorateve aktuale (ushqimit, veterinarisë dhe të higjienës) Aderimi në OBT Nëpërmjet shërbimit të ekstensionit të shpërndahet informacioni mbi inputet ekzistuese e ato të reja dhe instruktimi i vazhdueshëm për përdorimin e tyre Realizimi i anëtarësisë në ISTA (Shoqata Ndërkombëtare e Testimit të Farërave)	Përmirësimi i infrastrukturës tregtare të tregut dhe informacionit tregtar Përfundimi i paketës ligjore të ligjeve dhe rregullave të marketingut Zbatimi i tarifave doganore konform parimeve të OBT-së dhe kontrolli mbi produktet e importuara Përkrahja e shoqatave të prodhuesve nëpërmjet sistemit të kreditit favorizues Mbështetja e sektorit privat nga shteti nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit për farërat, plehrat kimike e kontrollin e tyre si dhe ulja e taksës doganore për inputet e importit.
MARKETINGU DHE TREGTIA E INPUTEVE BUJQËSORE	Forcimi i rolit të tregut të inputeve bujqësore		

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
ORGANIZIMI I FERMAVE	Zbutja e kufizimeve të fermës në funksion të rritjes së të ardhurave të fermerit		
	Rritja e përmasës së fermës dhe ulja e nivelit të fragmentimit	Sigurimi i kushteve teknike për krijimin e tregut të tokës	Sigurimi i kushteve teknike për krijimin e tregut të tokës; nxitja e organizimit të shoqatave të prodhuesve.
	Rritja e nivelit menaxhues të fermerëve	Intensifikimi i informacionit përmes masmediave; kontaktet direkte me fermerët nëpërmjet shërbimit këshillimor	Rritja e kapacitetit të analizës ekonomike të MBU dhe shpërndarja e rezultateve
	Përmirësimi i strukturës së kapitalit fizik për t'iu përshtatur fermave të vogla		Lehtësimi i taksave doganore për importet e kapitaleve të domosdoshme për fermat dhe masat antimonopol në tregun e brendshëm
KREDIA DHE FINANCAT RURALE	Përmirësimi i financimit të fermave	Sigurimi i financimeve të huaja me objekt degë prioritare të prodhimit në ferma	Mbështetja e institucioneve të vetëmbajtura rurale
	Zhvillimi i një sistemi efektiv kredie	Zhvillimi i kredisë së vogël në zona rurale. Krijimi i shoqatave të kreditit	Krijimi i një rrjeti të qëndrueshëm privat të shoqatave të kredisë/kursimeve të zonave rurale

ГJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
ZHVILLIMI RURAL	Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës rurale Zhvillimi i mëtejshëm ekonomik i zonave rurale	Riparimi i pas krizës Projektimi i një masterplani në rrjetin e rrugëve (D.P.Rr) Rritja e punësimit nëpërmjet rehabilitimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe industrive të burimeve lokale.	Investime në infrastrukturën e vogël për të ndihmuar rritjen e sektorit privat Hartimi i programeve të veçanta dhe komplekse social-ekonomike.

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
KËRKIMI SHKENCOR	Institucionet kërkimore-shkencore do të jenë mbështetje e fuqishme e strategjisë së re të zhvillimit të bujqësisë dhe rritjes së prodhimit bujqësor e blegtoral	Përparësi për kërkim aplikativ Integrimi në sistemin e prodhimit të farnave dhe fidanave	Bashkëpunimi institucional me Universitetin Bujqësor dhe qendrat e tjera kërkimore
SHËRBIMI KËSHILLIMOR	Krijimi i një shërbimi këshillimor funksional, publik dhe privat	Pozicionim aktiv në strukturat e shërbimit këshillimor Asgjësimi i pesticideve stoqe nëpërmjet metodave të përparuara	Krijimi i komitetit të resurseve gjenetike Hapja e 5 qendrave rajonale këshillimore në gjithë vendin
SHËRBIMI I MBROJTJES SË BIMËVE	Krijimi i një shërbimi të mbrojtjes së bimëve me standardet fitosanitare ndërkombëtare	Përmirësimi ligjor në fushën e mbrojtjes së bimëve Ulja e kostos së shpenzimeve të mbrojtjes së bimëve duke rifilluar prodhimin në vend ose formulimin e pesticideve bazë dhe disa biopreparateve	Krijimi i strukturave të diferencuara të pesticideve për mbrojtjen e integruar të bimëve Hartimi i rregullores fitosanitare sipas standardeve të BE Rifillimi i prodhimit të pesticideve me bazë bakri dhe squfuri

SHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
INFORMACIONI STATISTIKOR	Përsosja e organizimit të shërbimit të statistikës dhe informacionit për rritjen e saktësisë dhe shpejtësisë të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave	Regjistrimi i pasurive të ekonomive bujqësore Përgatitja e ligjit "Për shërbimin e statistikave dhe informacionit në sistemin e bujqësisë dhe ushqimit" Zgjerimi i numrit të segmenteve për rritjen e saktësisë në informacionin statistikor Organizimi dhe ndërtimi i zgjedhjes së veçantë për bimët e rajonizuara si duhan, patate, ullinj, agrume etj. Konsolidimi i strukturave organizative në të gjitha nivelet e rrjetit të shërbimit statistikor	Zgjerimi i mëtejshëm i numrit të segmenteve për rritjen e saktësisë në informacionin statistikor Përdorimi i internetit në shërbimin statistikor Përsosja e mëtejshme e mbledhjes së të dhënave statistikore nëpërmjet rishikimit e futjes në përdorim të metodave bashkëkohore

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
POLITIKAT PYJORE DHE MJEDISORE	Zhvillimi progresiv dhe shfrytëzimi me kritere të qëndrueshme të pyjeve Rritja e kapaciteteve prodhuese për një sigurim konstant të produkteve drusore dhe jo drusore Politika e mjedisit do të synojë që zhvillimi i bujqësisë të bazohet në parimet ekologjike	Riorganizimi i shërbimit pyjor dhe policisë pyjore Transferimi i rreth 40% i sipërfaqeve pyjore dhe 60% i sipërfaqeve të kullotave në përdorim të komunave. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore - Krijimi i llogarive të të ardhurave për DPPK Hartimi i një kuadri të përshtatshëm legjislativ për mjedisin	Rehabilitimi i ekosistemeve të degraduara (ripyllëzim) të pyjeve Regjistrimi i përgjithshëm i pyjeve dhe kullotave Krijimi i departamentit të menaxhimit të burimeve natyrore në MBU. Stabilizimi i një buxheti për rehabilitimin mjedisor në bujqësi. Krijimi i Komitetit Shtetëror për burime gjenetike dhe Banka Kombëtare Gjenetike e Pyjeve dhe Kullotave

ÇËSHTJET	OBJEKTIVAT	PLANI I VEPRIMEVE	
		Afat shkurtër	**Afat mesëm**
PESHKIMI	Sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe ujërave të brendshme, duke synuar në një rritje graduale të prodhimit peshkor brenda kufijve optimalë të shfrytëzimit racional. Mbështetja e proceseve të ristrukturimit dhe modernizimit të veprimtarive prodhuese, rrjetit të marketingut, industrisë së peshkimit, infrastrukturës portuale dhe veprimtarive ndihmëse e të shërbimit për peshkimin detar për rritjen e prodhimit peshkor dhe të nivelit të punësimit. Zhvillimi me prioritet i akuakulturës në ujërat detare dhe ujërat e brendshme për rritjen e prodhimit, duke pasur në konsideratë ndikimin e mjedisit	Përmirësimet ligjore të ligjit "Për peshkimin dhe akuakulturën" dhe rregulloreve sipas direktivave të KE dhe FAO-s. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të peshkimit Ndërtimi i dy tregjeve të shitjes me shumicë të peshkut (Vlorë dhe Durrës) Ndërtimi i 2 shkallëve për riparimin e anijeve të peshkimit (Shëngjin, Vlorë) Zgjidhja e problemit të eksporteve të prodhimeve të përpunuara me vendet e KE Zbatimi i projektit për studimin e potencialeve të zhvillimit të akuakulturës detare dhe në ujërat e brendshme Realizimi i studimit për lagunat bregdetare për rritjen e prodhimit peshkor të tyre.	Hartimi dhe miratimi i planeve 2- ose 3-vjeçare për menaxhimin e peshkimit në det dhe në ujëra të brendshme Zbatimi në vazhdimësi i projekteve të kërkimit për vlerësimin e resurseve të peshqve detarë (fundore, pellagjike, moluske etj.) Ndërtimi i shkallës për riparimin e anijeve të peshkimit në Sarandë. Plotësimi me pajisje teknologjike dhe informatizimi i tregjeve me shumicë të peshkut (Vlorë dhe Durrës) Përgatitja e studimit për stabilizimin e flotës së peshkimit në Durrës si dhe ngritjen e qendrave të shërbimeve në të gjitha portet. Zbatimi i projektit të investimeve në lagunat bregdetare duke synuar projekte pilot për Nartën, lagunat e Lezhës etj. Nxitja e investimeve private për zhvillimin e akuakulturës detare dhe

			ujërave të ëmbla

V E N D I M

Nr. 834, datë 30.12.1998

PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE Sh.A.

Në mbështetje të ligjit nr.8433, datë 21.12.1998 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formës së privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, Sh.a.", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Të përgjithshme

1. Për privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare, Sh.a. (BKT), zgjedhja e investitorit të huaj, strategjik, të cilit do t'i transferohet, nëpërmjet shitjes, e drejta e pronësisë për shumicën e aksioneve të kësaj banke, të bëhet nëpërmjet një tenderi ndërkombëtar, të hapur. Kandidatët, që do të marrin pjesë në tender, duhet të jenë persona juridikë, të licencuar për ushtrimin e veprimtarisë bankare. Tenderi të zhvillohet në tri faza:

a) **Parakualifikimi**. Ky të bëhet në mbështetje të dokumenteve dhe të kritereve, të përcaktuara në anekset I dhe II, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

b) **Vlerësimi i ofertave**. Ky të bëhet në mbështetje të dokumenteve dhe të kritereve të vlerësimit, të përcaktuara në anekset III dhe IV, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

c) **Zgjedhja e fituesit**. Kjo të bëhet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave. Mbas përcaktimit të fituesit të paketës strategjike, ministri i Financave i propozon Këshillit të Ministrave, platformën e negocimit për pjesën tjetër të aksioneve.

2. Procedurat e tenderit realizohen nga Ministria e Financave.

3. Në privatizimin e BKT-së nuk do t'i nënshtrohet tenderit paketa e aksioneve, që mund të ofrohet për shitje tek investitorët e tjerë, nëpërmjet negociatave. Transferimi i së drejtës së pronësisë së aksioneve të BKT-së me negociata tek investitorët e tjerë, të cilët duhet të jenë të licencuar për ushtrimin e veprimtarisë bankare ose financiare, të bëhet duke respektuar kushtin që çmimi minimal i shitjes së një aksioni të jetë sa çmimi i tregut, i llogaritur dhe ofruar për shitje me tender.

II. Procedurat për privatizimin me tender të BKT-së

1. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 725, datë 19.11.1998 "Për privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare, Sh.a.", ministri i Financave nxjerr urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit me tender të BKT-së, si dhe të kritereve dhe të pikëve të vlerësimit të ofertave.

2. Dokumentacioni për privatizimin me tender, përgatitet nga Ministria e Financave në bashkëpunim me BKT-në. Në procesin e shqyrtimit përfundimtar të dokumenteve dhe zbatimit të procedurave të tenderit, Ministria e Financave të garantojë barazinë e informacionit për të gjithë kandidatët e interesuar, si dhe të sigurojë informacionin e nevojshëm për ta.

3. Dorëzimi dhe hapja e ofertave bëhet përpara komisionit të vlerësimit të ofertave.

4. Fillimi i procesit të privatizimit bëhet pas marrjes së aprovimit paraprak nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”

5. Para publikimit për privatizim bëhet një paraqitje e BKT-së tek investitorët strategjikë dhe tek investitorët e tjerë të interesuar.

6. Publikohet ftesa për tenderin e parakualifikimit të investitorëve në një numër të gazetës “Financial Times” dhe në tri gazeta me qarkullim kombëtar, në jo më pak se 3 (tre) numra të njëpasnjëshëm. Data e paraqitjes së ofertave për kualifikim nga kandidatët, përcaktohet në ftesë dhe afati nga data e publikimit të jetë jo më pak se 15 ditë. Kjo ftesë përmban:

a) emërtimin e bankës dhe vendndodhjen e saj

b) paketën e aksioneve të bankës që privatizohet

c) formën e tenderit

ç) formulën e plotë të privatizimit ose përcaktimin e paketave të veçanta të aksioneve të BKT-së

d) vendin dhe afatin për tërheqjen e dokumenteve të tenderit

dh) vendin, mënyrën dhe datën e saktë për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.

7. Investitorët strategjikë të interesuar, të paraqesin ofertën për parakualifikim, e cila duhet të përmbajë dokumentet e përcaktuara në aneksin I, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Bëhet parakualifikimi i investitorëve strategjikë të interesuar, në mbështetje të kritereve të përcaktuara në aneksin II, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Investitorët strategjikë, të kualifikuar, ftohen drejtpërdrejtë nga komisioni i vlerësimit të ofertave. Kjo ftesë përmban:

a) emërtimin e bankës dhe vendndodhjen e saj

b) paketën e aksioneve të bankës që privatizohet

c) formën e tenderit

ç) formulën e plotë të privatizimit ose përcaktimin e paketave të veçanta, të aksioneve të BKT-së

d) vendin dhe afatin për tërheqjen e dokumenteve të tenderit

dh) pagesën për tërheqjen e dokumenteve të tenderit

e) vendin, mënyrën dhe datën e saktë për dorëzimin dhe hapjen e ofertave

f) specifikime për garancinë e tenderit dhe përcaktimin e afatit përfundimtar të vlefshmërisë së ofertës.

10. Investitorët strategjikë të kualifikuar, paraqesin brenda afateve të përcaktuara në ftesëofertat e tyre, të cilat duhet të përmbajnë dokumentet e përcaktuara në aneksin III, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Bëhet vlerësimi i ofertave në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin IV, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Përcaktohet oferta më e mirë e investitorit strategjik, në bazë të kritereve të vlerësimit, dhe paraqitet për aprovim përfundimtar nga ministri i Financave në Këshillin e Ministrave, së bashku me kriteret për negocimin me investitorët e tjerë, bankarë dhe financiarë.

13. Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të investitorit strategjik dhe të kritereve të negocimit me investitorët e tjerë, bankarë dhe financiarë, për pjesën e mbetur të aksioneve të BKT-së, fillojnë njëkohësisht negocimet ndërmjet ministrit të Financave, investitorit strategjik dhe investitorëve financiarë.

14. Nënshkruhet marrëveshja në parim me investitorin strategjik të zgjedhur dhe investitorët financiarë, për transferimin e së drejtës së pronësisë.

15. Merret miratimi përfundimtar nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

16. Nënshkruhet kontrata ndërmjet ministrit të Financave, investitorit strategjik dhe investitorëve të tjerë të zgjedhur, për transferimin e së drejtës së pronësisë së aksioneve të bankës.

17. Bëhet transferimi i pronësisë së aksioneve të bankës, nga ministri i Financave tek investitori strategjik dhe investitorët e tjerë të zgjedhur.

III. Garantimi i tenderit

1. Kandidati për pjesëmarrje në tender duhet të sigurojë ofertën e vet para datës së hapjes së ofertave, duke ngrirë në një llogari bankare ose duke paraqitur një garanci në një bankë për llogari të ministrisë së Financave për një shumë 50 000 (pesëdhjetë mijë) USD. Shuma e ngrirë ose garancia bankare janë të vlefshme deri në përfundimin e tenderit. Data, mënyra e paraqitjes dhe elementet e tjerë, që kanë të bëjnë me sigurimin e ofertës, specifikohen në ftesën për tender.

2. Kushti i garancisë së tenderit do të kthehet në rast se:

a) ftesa për tender është anuluar

b) dokumentet e paraqitura për ofertë janë të pavlefshme

c) pjesëmarrësi nuk është fitues i tenderit

ç) kontrata nuk është përfunduar, për mospranim të kushteve të vendosura nga Ministria e Financave

3. Kushti i garancisë së tenderit nuk do të kthehet në rast se:

a) në pajtim me ftesën për tender, ajo është transformuar në një siguri suplementare për garantimin e përfundimit të kontratës.

b) anulohet nga kandidatët oferta e paraqitur në tender gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave

c) kandidati është gjetur përgjegjës për moslidhjen e kontratës

ç) kontrata nuk është përfunduar për çdo arsye që bie ndesh me interesat e kandidatëve të tjerë, pjesëmarrës në tender.

4) Me kërkesën e Ministrisë së Financave, kandidati është i detyruar ta paraqesë dokumentacionin përkatës për të vërtetuar cilësitë e veta, të vendosura në ofertë.

IV. Paraqitja dhe vlefshmëria e ofertave

1. Kandidatët do t’i paraqesin ofertat në zarfa të mbyllur, në tri kopje, njëra nga të cilat të jetë origjinale. Zarfat janë të vulosura, të kenë të shënuar emrin e kandidatit si dhe shënimet përkatësisht “origjinale” dhe “kopje”. Në çdo faqe të dokumenteve të ofertës duhet të jetë firma origjinale e kandidatit (ose e të autorizuarit prej tij). Ofertat duhet të arrijnë në vendin e përcaktuar në ftesën për tender para datës dhe orës së hapjes së ofertave.

2. Kandidati do të paraqesë vetëm një ofertë.

3. Ofertat e paraqitura në përgjigje të ftesës për tender, duhet të përmbajnë edhe një deklaratë me anë të së cilës kandidati angazhohet për:

a) pranimin e kushteve të përcaktuara në ftesën për tender

b) marrjen përsipër të detyrimeve dhe të shërbimeve që rrjedhin nga pranimi i këtyre kushteve

c) pagesën e shumës për çmimin e ofruar.

4. Dorëzimi dhe hapja e ofertave bëhet konform kërkesave të këtij vendimi dhe, mbi këtë bazë, vendoset për ofertat, të cilat janë të vlefshme për të vazhduar procedurën.

5. Pavarësisht nga vlefshmëria e ofertave dhe nga suksesi ose dështimi i tenderit, shpenzimet për përgatitjen e ofertave dhe për përfshirjen e kandidatit në tender, përballohen nga pjesëmarrësit e tenderit.

V. Konfidencialiteti

1. Deri në përfundimin e kontratës së shitjes, kandidati duhet të trajtojë, në mënyrë konfidenciale, përmbajtjen e ofertave, si dhe të gjitha faktet, informacionin dhe të dhënat e vëna në dispozicion të tij nga Ministria e Financave, në paraqitjen e BKT-së ose nëpërmjet çdo kanali tjetër konfidencial. Ai nuk do t'i japë informacion një pale të tretë.

2. Ministria e Financave ka të drejtë ta quajë ofertën e kandidatit përkatës të pavlefshme dhe ta anulojë atë, nëse kandidati ose ndonjë person tjetër, përfaqësues i tij, dhunon konfidencialitetin lidhur me tenderin.

3. Ministria e Financave duhet ta ruajë konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave deri në përfundimin e tenderit dhe të mos japë asnjë informacion për përmbajtjen e tij.

4. Ministria e Financave duhet t'i përdorë ofertat e paraqitura vetëm për vlerësim. Nëse ato do të duhet të përdoren për qëllim tjetër, të dyja palët duhet të bëjnë një kontratë të veçantë.

VI. Dorëzimi dhe hapja e ofertave

1. Ofertat dorëzohen dhe hapen në vendin dhe në kohën e përcaktuar në ftesën për tender, para komisionit të vlerësimit të ofertave.

2. Kandidatët ose personat e autorizuar prej tyre me prokurë të veçantë, mund të jenë të pranishëm në hapjen e ofertave.

VII. Komisioni i vlerësimit të ofertave

1. Ministri i Financave është kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave. Anëtarët e komisionit të jenë si më poshtë:

- dy përfaqësues nga Ministria e Financave
- një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë
- një përfaqësues nga Kryeministria
- një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit
- një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit
- një sekretar, punonjës në Ministrinë e Financave
- një këshilltar i huaj, i pavarur (anëtar pa të drejtë vote).

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave shpërblehet me një deri në dy paga mujore, sipas përcaktimit të ministrit të Financave.

3. Nuk duhet të marrin pjesë në komisionin e vlerësimit të ofertave:

a) një person, përfaqësues i ndonjë institucioni apo organizate, i cili është kandidat në tender

b) punëdhënës ose nëpunës, i cili ka marrëdhënie kontraktore me BKT-në

c) pronar i pjesshëm ose i vetëm, ose anëtar i një ndërmarrjeje apo biznesi ligjor, që paraqitet si kandidat

4. Çdo person, pjesëmarrës në komisionin e vlerësimit të ofertave, duhet të japë një deklaratë për lidhje gjaku, krushqie apo interesash me pjesëmarrësit në tender.

5. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të ruajnë konfidencialitetin. Ata duhet të përdorin informacionin e kërkuar në cilësinë dhe të drejtën e mësipërme, ekskluzivisht për qëllim të vlerësimit të ofertave.

6. Në procesin e privatizimit të BKT-së, Ministria e Financave, në bashkëpunim me komisionin e vlerësimit të ofertave, të kryejë detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

- koordinimin e të gjitha veprimeve për zbatimin me transparencë dhe objektivitet të akteve normative në fuqi për privatizimin e BKT-së
- sigurimin, në përputhje me ligjin në fuqi, të licencës për ushtrimin e veprimtarisë bankare nga BKT-ja
- përgatitjen e informacionit dhe të materialeve të tjera të nevojshme për shpërndarjen e tyre tek investitorët e interesuar, kundrejt nënshkrimit të një marrëveshjeje konfidencialiteti
- organizimin dhe zhvillimin e paraqitjes zyrtare të BKT-së
- marrjen e lejes paraprake nga Banka e Shqipërisë për fillimin e procedurave të privatizimit të BKT-së
- publikimin e ftesës për tenderin e parakualifikimit dhe pranimin e ofertës me dokumentet e parakualifikimit, të parashikuara në aneksin I, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi
- parakualifikimin e investitorëve strategjikë, në bazë të kritereve të vlerësimit, të përcaktuara në aneksin II, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi
- dërgimin e ftesave për tender tek investitorët strategjikë të kualifikuar, dhe pranimin e ofertave me dokumentet e përcaktuara në aneksin III, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe dokumentet e tjera, që përmban ftesa për tender
- vlerësimin e ofertave, në bazë të kritereve të përcaktuara në aneksin IV, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi, duke përdorur një sistem pikësh për elementët e secilit kriter
- përcaktimin e ofertës më të mirë të investitorit strategjik, në bazë të kritereve të vlerësimit, dhe paraqitjen për miratim përfundimtar në Këshillin e Ministrave, së bashku me kriteret e negocimit me investitorët e tjerë bankarë dhe financiarë
- zhvillimin e negociatave me investitorin strategjik, të aprovuar nga Këshilli i Ministrave dhe investitorët e tjerë të interesuar, më të mirë. Gjatë këtyre negociatave investitori strategjik dhe investitorët e tjerë të bëjnë “due diligence” të BKT-së (vlerësimin e aspekteve ligjore, financiare etj.), e cila do të zgjasë tre javë, nga koha e fillimit të negociatave deri në çastin e nënshkrimit të marrëveshjes në parim.
- nënshkrimin e marrëveshjes në parim me investitorin strategjik, të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe investitorët e tjerë, të zgjedhur nga negociata.
- përgatitjen e termave dhe të kushteve të kontratave përfundimtare të shitjes
- paraqitjen e kërkesës dhe të dokumenteve të tjera, të nevojshme në Bankën e Shqipërisë, për marrjen e miratimit përfundimtar prej saj, siç përcaktohet në ligjin nr. 8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”
- nënshkrimin e kontratave përfundimtare të shitjes
- transferimin e aksioneve, sipas termave dhe kushteve të kontratave, të nënshkruara nga ministri i Financave me investitorin strategjik dhe me investitorët e tjerë të interesuar.

VIII. Procedurat e vlerësimit të ofertave

1. Njëkohësisht me vlerësimin dhe hapjen e ofertave, komisioni i vlerësimit të ofertave mund të kërkojë informacion nga kandidatët e pranishëm në tender, me qëllim lehtësimin e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave. Pyetjet (që lidhen me to) dhe përgjigjet e dhëna nga kandidatët në tender, duhet të mbahen të regjistruara me shkrim. Kjo nuk do të

ndikojë në ndryshimin e kushteve të kërkesës së dorëzuar për tender, por vetëm në interpretimin e tyre.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave bën vlerësimin e ofertave si vijon:

a) komisioni vendos procedurën e vlerësimit me pikë të ofertave

b) secili anëtar i komisionit bën, në mënyrë të pavarur, vlerësimin me pikë për secilën ofertë, sipas sistemit të pikëve të përcaktuar në aneksin IV, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi, duke plotësuar formularin e parapërgatitur për këtë qëllim nga komisioni.

c) pas mbledhjes së pikëve të të gjithë anëtarëve të komisionit për secilën ofertë, në bazë të rezultatit bëhet renditja e ofertave, në mënyrë zbritëse, duke përcaktuar si ofertën më të mirë atë që vlerësohet me numrin më të madh të pikëve.

3. Në procesin e vlerësimit të ofertave komisioni vepron si vijon:

3.1. Krahason ofertat, në bazë të kritereve dhe të rëndësisë, të specifikuara në ftesën për tender, duke marrë parasysh dispozitat e këtij vendimi. Komisioni i vlerësimit të ofertave mund të kërkojë një raport me shkrim nga anëtari i komisionit pa të drejtë vote, për dhënien e një vlerësimi, i cili jep mundësinë për një vlerësim në një drejtim të caktuar, të veçantë.

3.2. Pas vlerësimit të secilës ofertë, komisioni i vlerësimit të ofertave harton një dokument argumentues për vlerësimin e bërë për ofertat. Ky dokument përmban:

a) objektin e tenderit dhe paketën e aksioneve të bankës së ofruar për shitje

b) një përmbledhje të shkurtër të procedurës, numrin e ofertave të marra

c) një përmbledhje të ofertave të marra

ç) kriterin kryesor të vlerësimit të ofertave dhe mendimin që shfaqet për ofertat individuale

d) kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes

dh) një vlerësim përmbledhës të rezultatit të procedurës së tenderit së bashku me renditjen e kandidatëve, sipas vlerësimit të bërë për ofertat e tyre.

IX. Deklarimi i pavlefshmërisë së ofertës dhe i pasuksesit të tenderit

1. Një ofertë duhet të deklarohet e pavlefshme nëse:

a) kandidati në tender nuk ka plotësuar garancitë e nevojshme

b) kandidati në tender ka shkelur konfidencialitetin e tenderit

c) kandidati në tender ka dështuar, kur bën një deklaratë të detajuar, të legalizuar të ofertës së tij, e cila nuk përputhet me ofertën e paraqitur

ç) kandidati në tender nuk ka plotësuar kushtet e ftesës për tender

2. Tenderi deklarohet i pasuksesshëm nëse:

a) asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk plotëson kërkesat e ftesës për tender

b) kërkesa të tjera përputhen me objektin e tenderit

c) Këshilli i Ministrave nuk miraton privatizimin e paketës së aksioneve të bankës.

X. Marrja e vendimit dhe njoftimi i rezultateve të tenderit

1. Komisioni vlerësimit të ofertave ka autoritetin e vlerësimit të ofertave dhe të nxjerrjes së rezultatit të tenderit.

2. Nëse nuk është përcaktuar ndryshe në ftesën për tender, ofertat duhen vlerësuar brenda 10 ditëve nga afati i dorëzimit dhe i hapjes së ofertave. Për rastet e veçanta, komisioni i vlerësimit të ofertave mund të zgjasë afatin e vlerësimit të ofertës edhe 5 ditë të tjera. Kjo u bëhet e njohur pjesëmarrësve në tender.

3. Në vendimin e rezultatit të tenderit duhen shënuar, përveç fituesit, edhe kandidatët e klasifikuar në tender në vendin e dytë e të tretë, me të cilët Ministria e Financave mund dhe duhet të përfundojë një kontratë, në rast se kontrata me fituesin dështon ose nëse fituesi nuk plotëson kontratën.

4. Ministria e Financave duhet ta komunikojë rezultatin e tenderit te të gjithë kandidatët, në tender brenda 5 ditëve nga dita e vlerësimit të ofertave.

5. Ministria e Financave, brenda 7 ditëve nga përfundimi i tenderit dhe nga nxjerrja e rezultateve, përgatit projektvendimin dhe relacionin përkatës, së bashku me të gjithë dokumentacionin e plotë të tenderit dhe ia paraqet për shqyrtim e miratim Këshillit të Ministrave.

XI. Mbyllja e kontratës

1. Kontrata me kandidatin fitues lidhet nga ministri i Financave, vetëm pasi Këshilli i Ministrave miraton procedurën e tenderimit dhe vendos për privatizimin e paketës së aksioneve të BKT-së.

2. Elemente të kontratës për shitjen e BKT-së janë të gjitha kërkesat e vendosura ne ftesën për tender dhe penalitetet përkatëse.

3. Kontrata duhet përfunduar brenda tre javëve nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave;

4. Nëse kontrata:

a) dështon se qeni e zbatueshme

b) pas nënshkrimit të kontratës, fituesi dështon për plotësimin e saj dhe për këto arsye, Ministria e Financave i jep fund kontratës

c) palët bien dakord t'i japin fund kontratës atëherë Ministria e Financave duhet të përfundojë një kontratë me ofruesin tjetër, sipas radhës së klasifikimit

5. Kontrata me kandidatin fitues bëhet e vlefshme, vetëm pasi të jetë dhënë miratimi përfundimtar nga Banka e Shqipërisë, siç përcaktohet në ligjin nr. 8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”

6) Ngarkohet Ministria e Financave për përcaktimin e sistemit të vlerësimit me pikë të elementeve të secilit kriter vlerësimi, si edhe e udhëzimeve të tjera, të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

ANEKSI I

Dokumentat që do të paraqiten për parakualifikim nga investitorët strategjikë

1. Aktin e themelimit dhe statutin e bankës duke përfshirë të dhënat mbi adresën e saktë të selisë, përshkrimin e natyrës dhe aktiviteteve të saj, llojet dhe përmasat e operacioneve bankare kombëtare dhe ndërkombëtare për jo më pak se 3 (tre) vitet e fundit, shumën e kapitalit, formën e drejtimit të bankës dhe administratorët e saj.
2. Raporti i auditorëve të jashtëm për tre vitet e fundit
3. Bilanci kontabël i audituar për tre vitet e fundit
4. Llogaritë e Fitimit dhe Humbjes të audituara për tre vitet e fundit
5. Pëlqimin me shkrim nga autoritetet e huaja përkatëse që mbikëqyrin veprimtaritë

financiare të drejtorisë qendrore të bankës së huaj për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë bankare në Shqipëri.

ANEKSI II

Kriteret e parakualifikimit të investitorëve strategjikë

1. Të jetë një bankë ndërkombëtare ose grup financiar me reputacion dhe eksperiencë të drejtpërdrejtë në fushën tregtare bankare

2. Të kryejë operacione tregtare bankare në vende të tjera

3. Të ketë burime financiare dhe teknike të sigurta për ta bërë bankën që privatizohet një bankë tregtare konkurruese në Shqipëri

4. Të ketë aftësi për të integruar bankën që privatizohet në operacionet ndërkombëtare të saj

5. Të ketë të dhëna që tregojnë se plotësohen kërkesat e ligjeve shqiptare për bankat dhe për licencimin nga Banka e Shqipërisë si dhe të të gjitha kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi.

ANEKSI III

Dokumentet që duhet të përmbajnë ofertat e investitorëve strategjikë

1. Përqindja e totalit të kapitalit, që kërkohen të blihen, të cilat në bazë të formulës së privatizimit duhet të jenë mbi 50 % të kapitalit total ekzistues të bankës, si dhe çmimi i ofruar i shprehur në USD.

2. Detajet se si do të bëhet rikapitalizimi i mëtejshëm i bankës

3. Burimet e financimit të operacioneve të përmendura në pikat 1 dhe 2 më sipër

4. Plani strategjik indikativ dhe plani i biznesit (pesëvjeçar) që mbështet ofertën, për bankën që privatizohet

5. Informacion mbi kualifikimin, reputacionin dhe përvojën e administratorëve të propozuar të bankës, duke përfshirë të dhëna mbi veprimtarinë tregtare ose profesionale të tyre për 7 (shtatë) vitet e fundit.

6. Detajet për aprovimet që duhet të merren nga autoritetet përkatëse të vendit të origjinës së investitorit, të cilat e lejojnë atë të blejë aksionet e bankës që privatizohet si dhe kopje të dokumenteve përkatëse.

ANEKSI IV

Kriteret për vlerësimin e ofertave të investitorëve strategjikë

A. Kriteret Financiare

1. Shuma e parave të ofruara për totalin e kapitalit të kërkuar për t'u blerë dhe për rikapitalizimin e bankës që privatizohet, e krahasuar me vlerën fillestare të aksioneve të ofruara për shitje. Vlera fillestare e aksioneve të ofruara për shitje do të përcaktohet nga Ministria e Financave si aksioner i vetëm i bankave me kapital tërësisht shtetëror. Ajo do të përfaqësojë vlerën e tregut të bankës mbështetur në mjetet dhe detyrimet aktuale si dhe vlerën e tyre potenciale për të ardhmen. Përqindja e totalit të kapitalit, që kërkohen të blihen, të cilat në bazë të formulës së privatizimit duhet të jenë mbi 50 % të kapitalit total ekzistues të bankës, si dhe çmimi i ofruar i shprehur në USD.

B. Kriteret Operacionale

1. Vlerësimi nga Komisioni i planit të biznesit të paraqitur, duke shqyrtuar çdo element të tij lidhur me ristrukturimin e bankës që privatizohet, teknologjinë e informacionit, trajnimin e stafit me qëllim që banka me rrjetin e saj ekzistues të bëhet një bankë tërësisht e modernizuar, dhe e aftë për të luajtur një rol të rëndësishëm e konkurrues brenda Shqipërisë dhe jashtë saj.

2. Mbështetur në operacionet ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare të investitorit dhe cilësitë e administratorëve të propozuar prej tij të vlerësohen mundësitë që ka ai, për kryerjen e aktivitetit bankar dhe futjen e produkteve të reja bankare në Shqipëri.

3. Eksperienca e investitorit lidhur me operimin si joint-venture jashtë vendit të origjinës së tij.

C. Sistemi i vlerësimit të elementeve

Nr.	**Kriteret**	**Vlerësimi në pikë**		
		V. I-rë	V. II-të	V. III-të
A.	**Elementet financiare**			
1.	Përqindja e aksioneve të kërkuara	40	40	20
2.	Shuma e ofruar për përqindjen e aksioneve të kërkuara	20	20	5
3.	Propozimet për rikapitalizim	15	10	10
B.	**Elementet strategjike**	**20**	**20**	**20**
1.	Strategjia 5 vjeçare e bankës brenda Shqipërisë	15	10	20
2.	Strategjia 5 vjeçare e bankës jashtë Shqipërisë	5	10	10
C.	**Elementet operacionale të plan-biznesit 5 vjeçar**	**30**	**30**	**40**
1.	Teknologjia e informacionit	10	5	10
2.	Struktura e menaxhimit	5	5	10
3.	Struktura e personelit	5	5	5
4.	Trajnimi i personelit	5	5	5
5.	Rrjeti i degëve brenda vendit	5	10	10
D.	**Elementet ndërkombëtare**	**10**	**10**	**10**
1.	Operacionet ekzistuese ndërkombëtare			
2.	Eksperienca në Joint-Ventures jashtë vendit të origjinës	5	5	3
	Totali	**100**	**100**	**100**

V E N D I M

Nr.6, datë 7.1.1999

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.598, DATË 30.12.1997 "PËR ADMINISTRIMIN DHE SHITJEN E MALLRAVE TË KONFISKUARA NË BAZË TË LIGJIT NR.8262, DATË 15.12.1997 "PËR VENDOSJEN E PULLAVE NË ARTIKUJT E DUHANIT DHE PIJEVE ALKOOLIKE DHE PËR NGJYROSJEN E NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.598, datë 30.12.1997, në pikën 11 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, të furnizohet me artikujt e duhanit, pije alkoolike e nënprodukte të naftës, sipas kërkesës së saj kundrejt çmimit fillestar të ankandit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.10, datë 14.1.1999

PËR DOKUMENTACIONIN E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Familjet, që pretendojnë për ndihmë ekonomike, duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtëm:

a. Deklaratën Tip, për gjendjen social-ekonomike të familjes, e cila plotësohet nga kryefamiljari një herë në vit.

b. Deklaratën specifike Tip, që plotësohet, detyrimisht, çdo muaj.

c. Çertifikatën e gjendjes familjare, ku shënohet data e regjistrimit në regjistrin themeltar dhe vendbanimi i mëparshëm.

d. Dokumentin e pronësisë, të lëshuar nga Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (kadastra) për tokat bujqësore, duke shënuar sipërfaqen dhe kategorinë e tokës.

Deklaratat Tip përgatiten sipas modeleve të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

2. Administratorët e zyrave të ndihmës ekonomike, në bashki a komuna, janë të detyruar të marrin, zyrtarisht, nëpërmjet listave, informacionin e nevojshëm, nga institucionet e mëposhtme:

- Zyra e punës
- Zyra e tatim-taksave
- Zyra e sigurimeve shoqërore
- Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (hipoteka)
- Zyra e regjistrimit të automjeteve
- Degët e bankave
- Seksionet pranë bashkive (urbanistika, tregu i lirë, etj.)
- Inspektoriati i punës

a. Këto institucione, si dhe sipas rastit institucione të tjera, janë të detyruara që brenda 10 ditëve nga marrja e listave të njoftojnë, zyrtarisht, zyrat e ndihmës ekonomike, në bashki a komunë.

b. Administratorët shoqërorë kanë të drejtë që, sa herë që lind nevoja të marrin informacion nga këto institucione.

c. Institucionet e mësipërme janë të detyruara të njoftojnë çdo muaj, zyrtarisht, administratorët e zyrave të ndihmës ekonomike, në bashki a komuna, për të gjitha ndryshimet që ndodhin në regjistrat e tyre përkatës.

3. Në rastet kur familja përfituese rikthehet në skemën e ndihmës ekonomike, pas një periudhe ndërprerjeje të pagesës deri në një muaj, ajo duhet të riplotësojë dokumentacionin e plotë.

4. Për kushte të veçanta social-ekonomike dhe shëndetësore të familjes, administratorët shoqërorë duhet të kërkojnë dokumente shtesë, plotësuese, të cilat përcaktohen me udhëzimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimin përkatës, në zbatim të këtij vendimi.

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.304, datë 30.6.1994, “Për dokumentacionin e përfitimit të ndihmës ekonomike” dhe pika 3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.605, datë 30.10.1995 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.12, datë 7.1.1999

PËR OBJEKTET QË DO TË MBETEN NË ADMINISTRIM TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Objektet dhe trualli në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare të jenë sipas pasqyrës nr.1, dhe nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Objektet dhe trualli që aktualisht janë në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, por që nuk janë përmendur në pasqyrën nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi, të veprohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

3. Parku i delegacioneve në Tiranë, në administrim të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit bëhet kalim kapital në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

4. Ngarkohen, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, prefekturat Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Gjirokastër, Shkodër e Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Pasqyra nr.1

REZIDENCAT QEVERITARE, VILAT DHE OBJEKTET E TJERA NË ADMINISTRIM TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE

I. Për rrethin e Tiranës	Sipërfaqja në m^2 ose ha
1. Pallati i Brigadave (godina)	**6405 m^2**
1.1. Parku i Pallatit të Brigadave	68 ha
1.2. Kisha e Pallatit të Brigadave	65 m^2
1.3. Shtëpia e Bujkut	130 m^2
1.4. Centrali elektrik i Pallatit të Brigadave	206 m^2
1.5. Sera	200 m^2
2. Shtëpia e Pritjes nr.4 (godina)	**690 m^2**
2.1. Territori përreth	3.5 ha
3. Objekti Nr.5 (godina e papërfunduar)	**1870 m^2**
3.1.Territori përreth	1.25 ha
4. Pallati i Kongreseve (godina)	**6500 m^2**
4.1. Territori përreth	2.2 ha
5. Vila nr.30 (godina)	**1840 m^2**
5.1. Sera	80 m^2
5.2. Magazinat ushqimore e garazhet	390 m^2
5.3. Territori përreth	1.4 ha
5.4. Kaldaja dhe kondicioneri jashtë rrethimit	690 m^2
6. Vila nr.31 (godina)	**3695 m^2**
6.1. Bar restorant “Tirana”	204 m^2
6.2. Serat	270 m^2
6.3. Territori përreth	6800 m^2
7. Objekti nr.32/1	314 m^2
7.1. Territori përreth	480 m^2

8. Objekti nr.42 (godina)	45 m^2
9. Grupi i vilave gjermane (godinat)	2000 m^2
9.1. Territori përreth	2565 m^2
10. Magazinat industriale (godinat)	768 m^2
10.1. Territori përreth	900 m^2
11. Parku i mjeteve të drejtorisë (godina+kapanone)	820 m^2
12. Berberi dhe kioska industriale (20+35 m^2)	55 m^2
13. Shtëpia e Pritjes nr.1 në Dajt (godina)	985 m^2
14. Shtëpia e pritjes nr.2 në Dajt (godina)	591 m^2
14.1. Territori i 2 (dy) vilave në Dajt	i hapur
II. Për rrethin e Durrësit	
1. Vila kodër (godina)	2353 m^2
1.1. Territori përreth	3500 m^2
2. Blloku i vilave në Plazh Durrës	
2.1. Vila nr.5 (godina)	758 m^2
2.2. Vila nr.6 (godina)	783 m^2
2.3. Vila nr. 11 (godina bashkëpronësi)	562 m^2
2.4. Vila nr.13 (godina)	378 m^2
2.5. Vila nr. 18/1 (godina)	445 m^2
2.6. Vila nr.20 (godina)	859 m^2
2.7. Vila nr.23 (godina)	1017 m^2
2.8. Vila nr.29 (godina)	410 m^2
2.9. Vila nr.30 (godina)	445 m^2
2.10. Restoranti (godina)	570 m^2
2.11. Godina e zyrave (godina)	423 m^2
2.12. Kaldaja (godina)	300 m^2
2.13. Sera (godina)	360 m^2
2.14. Godina e repartit ushtarak (godina)	350 m^2
2.15. Mjediset e shërbimit pranë vilës nr.5 e 23	108 m^2
2.16. Territori përreth	38 ha
III. Për rrethin e Pogradecit e Korçës	
1.1. Vila nr.1 në Pogradec (godina)	533 m^2
1.2. Vila nr.2, “ ”	533 m^2
1.3. Vila nr.3, “ ”	1162 m^2
1.4. Vila nr.4, “ ”	571 m^2
1.5. Vila nr.5, “ ”	571 m^2
2. Territori përreth, brenda rrethimit	4.3 ha
3.1. Klubi Pogradec (godina)	190 m^2
4.2. Godina e Gardës	545 m^2
5. Vila nr.2 në Korçë (godina)	760 m^2
5.1. Territori përreth	600 m^2
IV. Për rrethin e Vlorës	
1.1. Vila nr.1 (godina)	2000 m^2
1.2. Vila nr.2 bashkë me territorin	2693 m^2
1.3. Vila nr.6 (godina)	570 m^2
1.4. Vila nr.9 (godina)	382 m^2
1.5. Territori përreth vilave	15 ha

1.6. Vila në Dhërmi (godina+territori)	1281 m^2
V. Për rrethin e Shkodrës	
1. Shtëpia e Pritjes nr.1 (godina)	1778 m^2
1.1. Territori përreth	8900 m^2
2. Shtëpia e Pritjes në Velipojë (godina)	800 m^2
2.1. Territori përreth	5000 m^2
VI. Për rrethin e Elbasanit	
1. Shtëpia e Pritjes (godina)	780 m^2
1.1. Territori përreth	9500 m^2
VII. Për rrethin e Lushnjës	
1. Shtëpia e Pritjes në Divjakë (godina)	300 m^2
1.1. Territori përreth	1800 m^2
VIII. Për rrethin e Gjirokastrës	
1. Shtëpia e Pritjes (godina)	704 m^2
1.1. Territori përreth	4000 m^2
IX. Për rrethin e Sarandës	
1. Shtëpia e Pritjes (godina)	313 m^2
1.1.Territori përreth	2 ha

V E N D I M

Nr. 14, datë 7.1.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.152, DATË 5.4.1994 "PËR KUSHTET E PËRFITIMIT, SHUMËN DHE PROCEDURËN E DHËNIES SË PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE DHE TË SHTESAVE TË PENSIONEVE"

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7709, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 5.4.1994, pika 2 ndryshohet si vijon:

"Kërkesa ose propozimi për përfitimin e pensionit të posaçëm ose të shtesës së pensionit, bëhet nga i interesuari, organizatat ose shoqatat, vetëm nëpërmjet këshillit të bashkisë ose rrethit të vendbanimit të personit si dhe nga ministritë dhe institucionet qendrore".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 20, datë 21.1.1999

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROJEKTIT "PËR REHABILITIMIN E GRUPIT SEKTORIAL TË UJËSJELLËSIT TË TIRANËS DHE ASISTENCËN TEKNIKE TË MENAXHIMIT TË NDËRMARRJES SË UJËSJELLËSIT"

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin, në parim, të projektit "Për rehabilitimin e grupit sektorial të ujësjellësit të Tiranës dhe asistencën teknike në menaxhimin e ndërmarrjes së ujësjellësit".

2. Ngarkohet Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë të kërkojë financim për këtë projekt pranë qeverisë italiane, për shumën prej 60 (gjashtëdhjetë) miliardë lirash.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të negociojnë me palën italiane marrëveshjen, për financimin e projektit, në emër të qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të parashikojë në buxhetin e saj, si kosto lokale për të mbuluar kontributin e qeverisë shqiptare në projekt, shumën totale deri në 1.2 miliardë lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 22, datë 21.1.1999

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.43, DATË 17.1.1998 "PËR ORGANIZIMIN E PANAIREVE DHE TË EKSPOZITAVE TREGTARE"

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.43, datë 17.1.1998 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si vijon:

"Panairet dhe ekspozitat tregtare, me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, të organizohen në bazë të një kalendari vjetor, ku të përcaktohet lloji, koha dhe vendi ku do të zhvillohen.

Kalendari përgatitet nga Qendra Kombëtare e Panaireve dhe miratohet nga ministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë.

Dhomat e tregtisë dhe të industrisë organizojnë panaire dhe ekspozita, kombëtare dhe ndërkombëtare, në bazë të kalendarit vjetor, të përgatitur nga Qendra Kombëtare e Panaireve.

Panairet vendore organizohen nën drejtimin e dhomave përkatëse të tregtisë dhe të industrisë, me mbështetjen e organeve të pushtetit vendor.”.

2. Pika 3 ndryshon si vijon:

“Shoqëritë, që merren me organizimin e panaireve dhe të ekspozitave tregtare, kombëtare dhe ndërkombëtare, duhet të plotësojnë kriteret për aftësitë teknike, profesionale dhe garancitë financiare, të përcaktuara në rregulloren e Qendrës Kombëtare të Panaireve.”.

3. Pika 7 ndryshon si vijon:

“Ngarkohet Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për zbatimin e këtij vendimi.”.

4. Në vendim, fjalët “Ministria e Tregtisë dhe Turizmit” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.23, datë 21.1.1999

PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË PRIVATIZOHEN

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 129, 214, 215, të ligjit nr.7938, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në shoqëritë tregtare, që privatizohen, të cilat janë në procesin e shitjes së paketës së aksioneve të tyre, dhe gjatë veprimtarisë rezultojnë të kenë rritur vlerën e kapitalit themeltar, e vazhdojnë të konkurrojnë në treg, punonjësit e tyre përfitojnë deri në 12 paga mujore nga fitimi neto, i realizuar, i vitit ushtrimor. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në shpërndarjen e fitimit neto të realizuar nga shoqëria tregtare, përcakton, nga dividenti, shumën që u takon punonjësve.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.24, datë 21.1.1999

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.446, DATË 9.7.1998, "PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË" NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.684, DATË 28.10.1998

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 2, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.446, datë 9.7.1998, në kapitullin II, shkronja "c", në pikën 1, shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

"Në shoqëritë, ku paketa shtetërore është nën 50 për qind e aksioneve të shoqërisë, pasi të jetë zbritur përqindja e aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe për punonjësit e shoqërisë, pjesa e mbetur e paketës së aksioneve u ofrohet ortakëve të shoqërisë, pa ankand.

Në rast refuzimi, tërësor ose pjesor, të paketës së ofruar të aksioneve, procedohet me privatizimin e tyre me ankand, në këmbim të bonove dhe të lekëve të privatizimit.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.26, datë 14.1.1999

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.393, DATË 3.9.1992 "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE"

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992, ndryshuar me vendimin nr.213, datë 28.3.1998 bëhen këto shtesa:

a) Në lidhjen "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit" në shkronjën A 7 shtohet emërtimi, "Kancelari i Gjykatës së Lartë".

b) Në lidhjen 5-II, "Niveli i pagës për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore" shtohet numri rendor 2/1 me emërtimin "Kancelar në Gjykatën e Lartë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8362, datë 1.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Kasacionit dhe administrimin e shërbimeve gjyqësore”.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.27, datë 21.1.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.423, DATË 9.7.1998 “PËR PJESËMARRJEN, ME KONTRATË ADMINISTRIMI, TË SEKTORIT PRIVAT, NË NDËRMARRJET E UJËSJELLËSVE, TË BASHKISË SË TIRANËS DHE TË RRETHEVE TIRANË DHE DURRËS” DHE PËR PËRFSHIRJEN E NDËRMARRJES SË UJËSJELLËSIT TË BASHKISË SË TIRANËS DHE TË RRETHIT TË TIRANËS NË KONTRATËN PËR ASISTENCË TEKNIKE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.423, datë 9.7.1998, pika 1 ndryshon si vijon:

“Të miratojë formën e marrëveshjes me kontratë administrimi, për pjesëmarrjen e sektorit privat në ndërmarrjen e ujësjellësit të Durrësit.”.

2. Ndërmarrjet e ujësjellësit të bashkisë së Tiranës dhe të rrethit të Tiranës të përfshihen në kontratën për asistencë teknike.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.28, datë 21.1.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.730, DATË 19.11.1998 “PËR MIRATIMIN E RRITJES SË KUOTËS SË ANËTARËSIMIT NË FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.730, datë 19.11.1998, pika 2 ndryshohet si vijon:

"Shtesa e kuotës, prej 13 400 000 (trembëdhjetë milionë e katërqind mijë) SDR-she, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohet me kredi të marra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar ose të sigurohet me mjete të përshtatshme. Kjo shtesë nuk do të jetë element i shpenzimeve të buxhetit të shtetit.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.29, datë 21.1.1999

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SH.A. "ALBKROMI" DHE SH.A. "AMC" QË VEPROJNË NË SEKTORË ME RËNDËSI TË VEÇANTË STRATEGJIKË"

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Privatizimin e shoqërive tregtare "ALBKROMI" Sh.a., dhe "AMC", Sh.a.

2. Shoqëritë tregtare të mësipërme të fillojnë përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për privatizimin e shoqërisë.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të përgatisë aktet ligjore dhe nënligjore të nevojshme për privatizimin e shoqërive tregtare të mësipërme dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.32, datë 25.1.1999

PËR DHËNIEN NË ENFITEOZË TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇELIKUT, ELBASAN

Në zbatim të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.8333, datë 23.4.1998 "Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënien në enfiteozë të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqeve, Elbasan shoqërisë "Kurum International" sh.p.k., me qendër në Tiranë, për një periudhë kohe prej 20 vjetësh, sipas kushteve të përgjithshme të kontratës tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Punonjësit, që dalin të papunë nga lidhja e kësaj kontrate, të paguhen për një periudhë kohe prej dy vjetësh nga të ardhurat, që përfitohen nga kjo kontratë.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e procedurave të privatizimit apo të likuidimit të kësaj ndërmarrjeje në rast të mosrealizimit të kësaj kontrate.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.34, datë 7.1.1999

PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE DHE TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare është person juridik në vartësi të Këshillit të Ministrave. Ajo zhvillon veprimtarinë e saj me vetëfinancim në përputhje me ligjin për ndërmarrjet dhe për veprimtari të veçanta e specifike subvencionohet nga buxheti i shtetit.

Drejtori emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri.

2. Detyrat kryesore të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare janë:

a) kryen shërbime qeveritare të pritjes së delegacioneve të huaja, të personaliteteve të larta, të miqve e dashamirësve të vendit tonë etj., të cilët vijnë të ftuar nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave.

b) trajton me kushte banimi e ushqimi delegacionet e rangjeve të larta, që vijnë në ministri e institucione qendrore.

c) trajton e plotëson nevojat jetësore të personaliteteve të larta shtetërore të përcaktuara në këtë vendim.

d) plotëson kushtet e nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë shtetërore, si të mbledhjeve, konferencave, seminareve, veprimtarive ndërkombëtare etj., që kryhen në mjediset e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

e) në përputhje me aktet ligjore në fuqi ajo kryen aktivitet tregtar siç është: dhënia me qira e vilave, objekteve që ka në administrim, si dhe kryen veprimtari ekonomike të turizmit e të shërbimeve hoteleri për persona fizikë e juridikë vendas e të huaj. Për nevoja të veçanta në rrethet ku nuk disponon rezidenca apo vila, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare mund të marrë objekte me qira nga subjekte shtetërore apo private, vendas apo të huaj.

f) në objektet e saj, ku ka organizuar restorante, trajton kundrejt pagesës edhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, deputetët e Kuvendit dhe titullarët e institucioneve të tjera qendrore. Rregullat e caktimit të çmimeve miratohen nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare.

g) kryen veprimtari shitblerjeje, veprimtari prodhimi me porosi, riparim shërbime, shërbime me taksi dhe veprimtari të tjera të kësaj natyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Shpenzimet e përcaktuara në pikën 2, shkronjat a e b të këtij vendimi, përballohen nga institucionet përkatëse.

4. Rezidencat qeveritare, vila dhe objektet e tjera në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndryshimi i emërtimit nga rezidenca qeveritare në vila e anasjelltas, si dhe kalimi i tyre në administrim të bashkive e të këshillave të rretheve, bëhet me urdhër të Kryeministrit.

5. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, kur është e nevojshme mund të përdorë për veprimtarinë e mësipërme edhe nga objektet, që janë të klasifikuara rezidenca qeveritare.

6. Për kryerjen e riparimeve, rikonstruksioneve, mobilimin dhe pajisjen e rezidencave, vilave dhe objekteve të tjera, veç fondeve të planifikuara nga buxheti i shtetit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare mund të bashkëpunojë edhe me persona juridikë e fizikë vendas e të huaj, në përputhje me dispozitat ligjore. Ky bashkëpunim mund të shtrihet edhe për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si dhe për përdorimin më me efektivitet të pasurisë që administron.

7. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare kryen shërbime kundrejt pagesës për pritjet zyrtare e jozyrtare, dreka e darka që jepen në objektet e saj sipas kërkesës së bërë. Shpenzimet e kryera përballohen nga institucionet përkatëse.

8. Pritjet e të gjitha kategorive bëhen me autorizim me shkrim të titullarit të organit, që e ka në kompetencë dhe vërtetohen nga persona zyrtarë të autorizuar prej tij, të cilët përcaktojnë e përgjigjen për kategorinë e delegacionit dhe kuotën e trajtimit të tyre.

9. Tarifat minimale për vilat e objektet, që jepen me qira nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, miratohen nga Këshilli i Ministrave, kurse vetë Drejtoria, në vartësi nga kërkesa e oferta, mund t’i rritë ato pa asnjë kufizim.

10. Tarifat e fjetjes dhe rregullat për caktimin e çmimeve në valutë e në lekë të

mallrave e të artikujve të veprimtarisë tregtare të shitblerjes e të turizmit dhe marzhet sipas llojeve të prodhimit e të tregtimit, të shërbimeve qeveritare etj., miratohen nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare.

11. Presidenti i Republikës, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit dhe familjet e tyre, trajtohen sipas përkatësisë nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, institucionet përkatëse dhe Klinika Qeveritare për kushtet jetësore të banimit, pushimit, furnizimit me artikuj ushqimorë e industrialë, shërbimit mjekësor dhe personel shërbimi etj., si në rastin kur banojnë në rezidenca qeveritare ashtu dhe kur ata banojnë në apartamentet e tyre. Trajtimi me ushqime të bëhet me kosto, duke iu llogaritur në pagesë vetëm vleftën e lëndës së parë.

12. Personaliteteve të mësipërm, iu vihet në përdorim për banim nga një rezidencë, në administrimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, i pajisur në mobilie dhe inventar përkatës, në përputhje me mjediset e banesës.

Kur personalitetet e lartpërmendur banojnë në apartamentet e tyre Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare pajis me mobilie dhe inventarin përkatës vetëm dhomën e pritjes dhe atë të punës, të cilët mbeten si inventar i kësaj Drejtorie.

13. Për Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare përballon këto shpenzime:

a) për mirëmbajtjen e rezidencave qeveritare dhe mjediseve të tjera rrethuese, për kompletimin me mobilie e orendi, pajisje e mirëmbajtjen e tyre, kur banojnë në rezidencat qeveritare, të parashikuara në pikën 13 të këtij vendimi.

b) për mbajtjen e personelit të nevojshëm të shërbimit për secilin personalitet sipas lidhjes nr.1 bashkëngjitur, si kur banojnë në rezidencat qeveritare ashtu dhe kur personalitetet banojnë në apartamentet e tyre.

c) për qira, ujë, energji elektrike e ngrohje, në rezidencat qeveritare apo në apartamentet e tyre.

d) për bisedime e lidhje telefonike në rezidencat qeveritare apo në apartamentet e tyre.

14. Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe familjeve të tyre në kohën e pushimit, iu vihet në dispozicion nga një apartament në rezidencat që administron Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në qendrat e pushimit.

Shpenzimet për qira, ujë, energji elektrike, ngrohje, lidhje telefonike etj., përballohen nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, ndërsa shpenzimet për ushqimin përballohen sipas kritereve të përcaktuara në pikën 12 të këtij vendimi.

15. Ish-Presidentit të Republikës për një periudhë 4-vjeçare nga mbarimi i mandatit, ish-Kryeministrit dhe ish-Kryetarit të Kuvendit për një periudhë 2-vjeçare nga mbarimi i mandatit, zëvendëskryeministrit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, për kohën e pushimit iu vihet në dispozicion sipas mundësive, apartament në rezidencat dhe vilat që administron Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, kundrejt tarifave të caktuara nga kjo drejtori.

16. Shpenzimet që bëhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe nënkryetarët e Kuvendit për pritjet, dreka e darka zyrtare, që jepen nga këto personalitete, si dhe shpenzimet për kafe, që bëhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, përballohen nga fondet e vetë institucioneve, që përfaqësojnë autoritetet e lartpërmendura.

17. Për kryerjen në kohë e me cilësi, të gjithë veprimtarisë së përcaktuar në këtë vendim, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare ngarkohet të blejë mallra me cilësi të lartë, sipas rregullave ligjore e nënligjore për prokurim publik, ndërsa për nevoja të domosdoshme lejohet të kryejë pagesë me lekë në dorë deri në 200 000 (dyqind) mijë lekë në ditë.

18. Për artikujt ushqimorë dhe industrialë, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të furnizohet me përparësi, kundrejt pagesës, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994 "Për administrimin e sendeve, që kalojnë në dobi të shtetit, nga kundërvajtjet administrative".

19. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të hartojë rregulloren e brendshme, e cila miratohet nga këshilli i saj drejtues.

20. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.361, datë 21.9.1991 "Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", pikat 1,2,3,4 dhe 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.404, datë 24.10.1991, vendimi nr.485, datë 29.7.1996, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 8.10.1996, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lidhja nr.1

LISTA E PERSONELIT TË SHËRBIMIT

I. Për Presidentin e Republikës

1. Kuzhiniere	Nr. i Punonjësve	1
2. Kameriere	"	1
3. Punëtor pastrimi	"	1

II. Për Kryeministrin

1. Kuzhiniere	Nr. i Punonjësve	1
2. Punëtor pastrimi	"	1

III. Kryetarin e Kuvendit

1. Kuzhiniere	Nr. i Punonjësve	1
2. Punëtor pastrimi	"	1

Shënim: Personeli tjetër teknik sigurohet sipas nevojave nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare

Lista nr.1

REZIDENCAT QEVERITARE, VILAT DHE OBJEKTET E TJERA NË ADMINISTRIM TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE

I. Për rrethin e Tiranës

1. Pallati i Brigadave me të gjitha anekset e territorin përreth.
2. Shtëpia e Pritjes nr.4 me gjithë territorin përreth
3. Objekti nr.5 me gjithë territorin përreth.
4. Pallati i Kongreseve me gjithë territorin përreth.

5. Vila nr.30 me gjithë territorin përreth.
6. Vila nr.31 me të gjitha anekset e territorin përreth.
7. Bar Restorant “Tirana” dhe serat.
8. Objekti nr.32/1 me gjithë territorin përreth.
9. Objekti nr.42.
10. Grupi i vilave gjermane dhe territori përreth.
11. Magazinat industriale dhe territori përreth.
12. Parku i mjeteve të drejtorisë.
13. Berberi dhe kioska industriale.
14. Shtëpia e Pritjes nr.1 në Dajt dhe territori përreth.
15. Shtëpia e Pritjes nr.2 në Dajt dhe territori përreth.

II. Për rrethin e Durrësit
1. Vila kodër dhe territori përreth.
2. Vila nr.5 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
3. Vila nr.6 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
4. Vila nr.11 në Plazh Durrës e territori përreth.
5. Vila nr. 13 në Plazh Durrës e territori përreth.
6. Vila nr.18/1 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
7. Vila nr.20 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
8. Vila nr.23 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
9. Vila nr.29 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
10. Vila nr.30 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
11. Restoranti (Stabilimenti i ri).
12. Kaldaja.
13. Godina e zyrave.
14. Godina e repartit ushtarak.
15. Sera, mjediset e shërbimit pranë vilës nr.5 e 23 e territori i gjelbëruar përreth bllokut të vilave.

III. Për rrethin e Pogradecit e Korçës
1. Vila nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5, si dhe territori përreth, brenda rrethimit.
2. Klubi Pogradec.
3. Godina e Gardës.
4. Vila nr.2 në Korçë e territori përreth.

IV. Për rrethin e Vlorës
1. Vila nr. 1 e territori përreth, përfshirë anekset për plazh.
2. Vila nr.2 e territori përreth.
3. Vila nr.6 e nr.9 e territori përreth.
4. Vila në Dhërmi e territori përreth.

V. Për rrethin e Shkodrës
1. Shtëpia e Pritjes nr. 1 e territori përreth.
2. Shtëpia e Pritjes në Velipojë e territori përreth.

VI. Për rrethin e Elbasanit

1. Shtëpia e Pritjes e territori përreth.

VII. Për rrethin e Lushnjës
1. Shtëpia e Pritjes në Divjakë e territori përreth.

VIII. Për rrethin e Gjirokastrës
1. Shtëpia e Pritjes e territori përreth.

IX. Për rrethin e Sarandës
1. Shtëpia e Pritjes e territori përreth.

V E N D I M

Nr.35, datë 21.1.1999

PËR RIORGANIZIMIN E DREJTORIVE TË POLICISË NË PREFEKTURA

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 9, të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 "Për policinë e rendit", me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Riorganizohen drejtoritë e policisë në prefektura, dhe të gjitha strukturat e shërbimeve përbërëse, me mision drejtimin e lartë, kontrollin dhe koordinimin e veprimtarisë së komisariateve në territorin e prefekturave. Drejtoria është përgjegjëse për realizimin e parimeve dhe të misionit të policisë, nëpërmjet zbatimit korrekt të ligjeve, akteve nënligjore në fuqi dhe të parimeve të përgjithshme të drejtimit të policisë. Drejtoritë janë në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Rendit Publik.

2. Në përputhje me misionin dhe detyrat e përgjithshme, ministri i Rendit Publik miraton kompetencat dhe detyrat funksionale të drejtorive të policisë në prefektura dhe të strukturave përbërëse.

3. Struktura, përbërja organike e këtyre drejtorive, si dhe të komisariateve e të shërbimeve të veçanta, në varësi, miratohen nga ministri i Rendit Publik, brenda limitit organik, ekzistues, të miratuar.

4. Emërimi, shkarkimi dhe lëvizja nga detyra e drejtorëve të drejtorisë së policisë në prefektura bëhet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Rendit Publik.

5. Policia e rretheve Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Korçë dhe Vlorë, deri më tani e organizuar në dy komisariate, të riorganizohet në një komisariat të vetëm.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.665, datë 2.9.1996 "Për krijimin e drejtorisë së policisë, Tiranë"; nr.320, datë 15.8.1997 "Për krijimin e drejtorive të policisë në rrethet Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Korçë dhe Vlorë dhe Korçë"; nr.473. datë 3.11.1998 "Për krijimin e drejtorive të policisë në prefektura" shfuqizohen.

7. Efektet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i vitit 1999, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.36, datë 21.1.1999

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.221, DATË 4.4.1998, NR.319, DATË 23.5.1998, NR.250, DATË 30.4.1998 DHE NR.178, DATË 6.3.1998

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.221, datë 4.4.1998 "Për vënien në dispozicion të kompanisë administruese Deloitte & Touche të grupit të shoqërimit të policisë", bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshohet si vijon:

"Për periudhën deri në fund të muajit mars 1999, në dispozicion të kompanisë administruese Deloitte & Touche të vihet grupi i shoqërimit me forca policie nga Ministria e Rendit Publik.".

- Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Fondi i pagave dhe shpenzimet e tjera të eskortës së policisë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.221, datë 4.4.1998, të përballohet nga Ministria e Rendit Publik brenda buxhetit të vitit 1999.".

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.319, datë 23.5.1998 "Për kontrollin dhe administrimin e shoqërive huamarrëse, që janë në proces hetimi dhe gjykimi nga kompania Pricewaterhouse Coopers", pika 7 ndryshohet si vijon:

"Kompanisë Pricewaterhouse Coopers, në ushtrimin e detyrës, për kontrollin dhe administrimin, deri në fund të muajit janar 1999, i vihet në dispozicion një grup shoqërimi, i përbërë nga një oficer dhe 2 punonjës policie, së bashku me një autoveturë. Fondi i pagave dhe shpenzimet e tyre përballohen nga buxheti i vitit 1999 miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.".

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250, datë 30.4.1998 "Për dhënie asistence ligjore kompanisë Deloitte & Touche, gjatë procesit të likuidimit të shoqërive huamarrëse", pika 1 ndryshohet si vijon:

"Kompanisë administruese Deloitte & Touche, për procesin e likuidimit të shoqërive tregtare, që kanë grumbulluar kapitale nga publiku i gjerë, i sigurohet asistencë ligjore deri në përfundimin e procesit të shitjes. Fondi i pagave përballohet nga buxheti i caktuar për Grupin Mbikëqyrës, në planin e vitit 1999.".

4. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 6.3.1998 "Për caktimin e ekspertëve financiare të pavarur në kontrollin e regjistrave ose të librave të shoqërive huamarrëse", bëhen këto ndryshime:

- Pika 2 ndryshohet si vijon:

"Si ekspertë financiarë të pavarur në subjektet e kontrollit të përmendur në pikën 1të vendimit, nga Grupi Mbikëqyrës caktohen 6-8 persona nga lista e personave që i

bashkëlidhet vendimit.”.

- Pika 9, ndryshohet si vijon:

“Fondi i pagave të grupit të eksperteve financiarë të pavarur përballohet nga buxheti i caktuar për Grupin Mbikëqyrës në planin e vitit 1999.”.

5. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Financave dhe Grupi Mbikëqyrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.38, datë 25.1.1999

PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË KONCESION TË SH.A. “SUPERFOSFATIT” KURBIN

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëria anonime “Superfosfati” Kurbin t’i jepet në koncension kompanisë franceze “EVERTRADE” s.a. sipas projektit të pakërkuar, propozuar nga kjo kompani.

2. Forma e kontratës koncesionare të jetë R.O.O. (Rehabilitim, Pronësi, Shfrytëzim).

3. Organi i autorizuar shtetëror për negocimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate të jetë Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e procedurave të privatizimit apo të likuidimit të kësaj ndërmarrjeje në rast të mosrealizimit të kësaj kontrate.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.39, datë 21.1.1999

PËR RISHIKIMIN E FUNKSIONEVE, TË STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË KRYEMINISTRISË DHE TË DISA MINISTRIVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Rishikimi i funksioneve të Kryeministrisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Pushtetit Lokal, për të rritur efektivitetin në realizimin e detyrave, sipas fushave përkatëse.

Për ndryshimet në funksionet ekzistuese të përgatiten, sipas rastit, projektet e akteve ligjore dhe nënligjore, me argumentet përkatëse.

2. Rishikimin e strukturave organizative, organikat dhe mënyrën e shpërndarjes së funksioneve në secilin organ dhe për plotësimin e vendeve vakant të zbatohen dispozitat ligjore.

3. Rishikimi i funksioneve dhe i organikave për Kryeministrinë dhe për Ministrinë e Drejtësisë të përfundojë brenda muajit mars 1999, ndërsa në Ministrinë e Financave dhe atë të Pushtetit Lokal brenda muajit qershor 1999.

4. Deri në miratimin e strukturave të reja, plotësimi i vendeve vakant të bëhet nga ministrat përkatës, duke informuar Departamentin e Administratës Publike në Kryeministri.

5. Për nevojat aktuale, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqiten propozimet dhe, pasi të merret miratimi, të procedohet menjëherë, për plotësimin e vendeve vakant, në përputhje me rregullat në fuqi.

6. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Koordinimit Qeveritar, ministri i Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.43, datë 21.1.1999

PËR MBULIMIN E VLERËS SË MALLRAVE TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE TË VJEDHURA E TË GRABITURA NË DEPOT E DREJTORISË SË REZERVAVE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997

“Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vlera e pajisjeve të televizionit “Euro Vefa”, të shoqërisë “Vefa Holding”, sh.p.k. në administrim për 400 000 (katërqind mijë) USD dhe vlera e pijeve alkoolike të shoqërisë “M.Leka” në administrim për shumën prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) USD, sipas çmimit të vlerësimit të administratorëve të tyre, të mbajtura në ruajtje pranë depove të rezervave Shtetërore, në kundër, për llogari të shoqërive huamarrëse subjekte të kontrollit, të vjedhura e të grabitura në ngjarjet e muajit shtator 1998, t’u kthehet këtyre shoqërive për shlyerjen e kreditorëve.

2. Fondi në vlerë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të mbulohet nga të ardhurat e planit financiar të vitit 1999 të Drejtorisë së Rezervave Shtetërore.

3. Ngarkohen Drejtoria e Rezervave Shtetërore dhe Grupi Mbikëqyrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.48, datë 28.1.1999

PËR KRIJIMIN E BORDIT TË HETIMIT TË AKSIDENTEVE DHE TË INCIDENTEVE AJRORE TË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 50 të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 “Për aviacionin civil shqiptar”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Objekt i këtij vendimi është hetimi i shkaqeve të aksidenteve e të incidenteve ajrore dhe parandalimi i tyre në të ardhmen.

2. Bordi i hetimit të aksidenteve dhe incidenteve ajrore të jetë me këtë përbërje:

- Drejtori i përgjithshëm i aviacionit civil kryetar
- Drejtori i drejtorisë së inspektoratit aeronautik i DPAC-së zëvendëskryetar
- Specialist nga drejtoria e inspektoratit aeronautik të DPAC-së anëtar
- Specialist nga drejtoria e trafikut ajror të DPAC-së anëtar
- Specialist nga drejtoria e standardeve teknike dhe sigurisë së DPAC-së anëtar

3. Në rastet e aksidenteve apo të incidenteve ajrore, civile, me dimension ushtarak, hetimi të realizohet në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me rregullat e aviacionit civil.

4. Bordi i hetimit të aksidenteve dhe incidenteve ajrore të funksionojë i pavarur nga

pavarur nga çdo organ tjetër, interesi i të cilit mund të bjerë ndesh me detyrën që i është besuar bordit të hetimit.

5. Bordi i hetimit të aksidenteve dhe incidenteve ajrore, në bashkëpunim edhe me organet përkatëse hetimore, të ketë këto të drejta:

- të hyjë lirshëm në vendin e aksidentit apo incidentit, ku ndodhet avioni apo pjesë të tij;
- të sigurojë një listë të plotë të të gjitha provave, si dhe lëvizjen e kontrolluar të tyre, për qëllime ekzaminimi;
- liri të plotë në shfrytëzimin e përmbajtjes së dokumentacionit teknik dhe të fluturimit, si dhe të regjistruesve të fluturimit;
- mundësinë e marrjes së rezultateve të ekzaminimit të trupave të viktimave ose të testeve të bëra për këtë qëllim;
- mundësinë e marrjes së rezultateve nga ekzaminimet e personave, të përfshirë në operimet e avionit, ose të testeve, të bëra për këtë qëllim;
- mundësinë e marrjes së analizave laboratorike të karburantit, gazrave, lëngjeve të avionit etj.;
- të pyesë dëshmitarët;
- mundësinë e marrjes së çdo informacioni ose të dhëne që kanë pronari, operuesi apo prodhuesi i avionit, si dhe autoritetet e aviacionit civil.

6. Për realizimin e përgjegjësive dhe të qëllimeve të ngarkuara e që kanë të bëjnë me grumbullimin, hetimin dhe ekzaminimin e të gjitha provave materiale, të gjithë institucionet shtetërore të mbështesin punën e bordit të hetimit, duke vënë në dispozicion të tij të gjitha mjetet e kërkuara, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim.

7. Çdo aksident ose incident ajror është subjekt i një hetimi të plotë, nga ana e bordit të hetimit.

Procedurat që duhen ndjekur, masat që duhen marrë dhe koha që nevojitet për realizimin e hetimeve të tilla, përcaktohen nga bordi i hetimit.

8. Kryetari i bordit të hetimit të aksidenteve dhe të incidenteve ajrore informon ministrin e Punëve Publike dhe Transportit për ecurinë e hetimeve të aksidentit apo të incidentit ajror.

9. Ministria e Rendit Publik, nëpërmjet organeve të veta, të marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e vendit të ngjarjes, duke zbatuar rregullat e përcaktuara për këtë qëllim.

10. Në rast nevoje mund të kërkohet asistenca apo ndihma në mjete, pajisje apo me ekspertë të hetimit, nga një shtet, anëtar të LICAO-s, i cili nuk është përfshirë në aksident.

11. Çdo hetim, i kryer nga bordi i hetimit, shoqërohet me një raport të formuluar në formën e duhur, duke përcaktuar llojin dhe seriozitetin e aksidentit apo të incidentit ajror.

Ky raport deklaron qëllimin e hetimit, siç përcaktohet në pikën 1, dhe kur është e nevojshme, rekomandimet për veprimet, të cilat duhen ndërmarrë për sigurinë ajrore.

12. Konkluzionet e hetimit bëhen publike në raportin final të aksidentit apo të incidentit ajror në një kohë sa më të shkurtër, dhe, nëse është e mundur, brenda 12 muajve nga data e ndodhjes së aksidentit apo incidentit ajror.

Raporti final i dërgohet ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, si dhe të gjitha

institucioneve shtetërore, të interesuara.

13. Ministri i Punëve Publike dhe Transportit nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, u dërgon një kopje të raportit final të gjitha shteteve të interesuara, si dhe Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO).

14. Shpenzimet, për realizimin e hetimit të aksidenteve dhe incidenteve ajrore, mbulohen nga buxheti i shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.50, datë 28.1.1999

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MBI TË CILËN DO TË LLOGARITET TAKSA E SOLIDARITETIT

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Për efekt të pagimit të taksës së solidaritetit, të parashikuar në nenin 6, në shkronjën “r” (lidhja 10, pika 6) të ligjit nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, si pagë mujore do të llogaritet paga bazë, pa shtesat që kanë karakter të përhershëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

U dorëzua për shtyp më 29.05.2000
Doli nga shtypi më 31.05.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Tipografia Ushtarake”